E L I F E L U ZH A

FITORJA E KOSOVËS NË RAMBUJE

Kolegji Universitar VICTORY

Fakulteti i Politikës Ndërkombëtare dhe i Diplomacisë

FITORJA E KOSOVËS NË RAMBUJE

ELIFE LUZHA

Prishtinë, 2009

Këtë punim ua dedikoj dy fëmijëve të mi Arbrit dhe Besfortit, për dashurinë, respektin dhe përkrahjen e madhe

që më kanë ofruar gjatë këtyre tre viteve studimi të cilat po i përmbylli me këtë temë.

P Ë R M B A J T J A

PËRMBAJTJA 3
HYRJE 5
KAPITULLI I: COPTIMI I TOKAVE SHQIPTARE NGA FUQITË E MËDHA 7
Paqja e ashpër 7
Shqiptarët e pushtuar 8
Terrori mbi shqiptarët vazhdoi 8
Suprimimi i autonomisë së Kosovës 10
Levizja Pacifiste 11
Kosova ndër rrjetat e marrëveshjeve 12
Formacionet e armatosura të organizimit ushtarak 14
Raçaku krim kundër njerëzimit 16
Vendosmëria për ndërhyrje ushtarake 17
KAPITULLI II: FITORIJA E KOSOVËS NË RAMBUJE 20
Kosova të flas me një zë të vetëm 20
Parimet e grupit të Kontaktit dhe thirrja e Adem Demaçit për refuzimin e tyre 21
Platforma politike e shtabit të përgjithshëm të UÇK-së 22
Mbrojtësit e kështjellave në Kështjellë 23
Delegacioni serb në negociatat për Kosovën në Rambuje 24
Takimet e para 25
Fillimet e punës në Kështjellë26
Marrëveshja 28
Vërejtjet e delegacionit shqiptar rreth Marrëveshjes29
Kushtetuta (Aneksi 1) 30
Vërejtjet në secilin aneks veç e veç 31
Vërejtjet e delegacionit serb 33
Dy ditë para përfundimit: Rreziku i dështimit të konferencës 34
Roli i Sekretares së SHBA-ve37
Dita e fundit e konferencës në Rambuje 39
Delegacioni shqiptar i thot po marrëveshjes 40
KAPITULLI III: DELEGACIONI SHQIPTAR KTHEHET NË ATDHE PËR TË MARR MENDIMIN E POPULLIT 42
Dorëheqja e Adem Demaçit 42
Zyrtarizim i Marrëveshjes 43
Qeveria e Unitetit 45
Kosova fitoi në Rambuje 45
Përmbyllje 48
Bibliografia 48

PUNIM DIPLOME

Mentori: Prof. Dr. Paskal Milo

H Y R J E

Si shqiptare përjetoj dhembje të madhe kur kujtoj që atdheu im, Kosova, u nda nga Shqipëria. Sidoqoftë, shqiptarët kurrë nuk do ta duronin zgjedhën Serbe. Kështu shprehej, në një harmoni të gjerë mbarëkombëtare zemra e Isa Boletinit, si një frymëmarje e dhimbëshme homerike dalë nga gjakosja e tokave shqiptare, copëtuar për oreksin e pangopur sllav. Zhvillimet njerëzore natyrshëm kalojnë nëpër faza të cilat bartin me vete interesa të caktuara, parime brënda strategjish e taktikash që e përcaktojnë më gjerë botën e që nuk varen thjeshtë nga viktima. Idenditeti dhe shqetësimi shqiptar edhe përkundër politikës së shteteve përkatëse ka zgjuar shumë studiues të huaj të hulumtojnë gjenezën dhe historinë e lavdishme shqiptare, prejardhja ilire e të cilëve tanimë nuk është e kontestuar.

Periudha e pas Luftës së Parë Botërore njohu një fuqi të re, ate amerikane, e cila solli një vizion të ri për të drejtën e popujve, në tërësi kundër vizioneve dhe interesave tradicionale të fuqive europiane. Kjo ngjalli shpresat e shqiptarëve për një zgjidhje të drejtë të çështjes së tyre. Por lufta e shqiptarëve për liri do të jetë e gjatë e me mundime Sizifi e sakrifica Prometeu deri në ditët tona.

Unë do të doja që në mënyrë kronologjike të paraqes sado shkurt qëndresën shqiptare kundrejt pushtuesve sllavë. Për të patur një shpjegim sa më të qartësuar, do të bëj një ndarje në tre kapituj dhe shkrimin do ta përqëndroja rreth tezës se në shkallëzimin historik të saj: A ishte Rambuje fitore për Kosovën!?

Në kapitullin e parë, kryesisht do të përdor metodën empirike dhe analitike; do të them fjalën time për copëtimin e tokave shqiptare në Shën Stefan më 1878 nga dhe do të pasojnë luftërat e shqiptarëve për bashkimin e tyre.

Shqipëria u shpall shtet më 1912 por mëse gjysma e saj mbeti jashtë kufijve etnik. Nga këtu u rindez me fuqi të re idenditeti kombëtar edhe aspirata e popullit shqiptar për bashkim. Lindin pyetjet: si i trajtuan serbët shqiptarët gjatë pushtimit mizor? Po Mbretëria e S.K.S. a e ndryshoi politikën ndaj shqiptarëve? Çfarë solli LNÇ për shqiptarët në ish'Jugosllavi dhe si do të trajtohen në Federatë? Çfarë fituan shqiptarët e Kosovës më 1974, dhe çfarë humbën me ardhjen e S. Millosheviqit në pushtet? Janë pyetje që do mundohem t'u përgjigjem me zërin tim në këtë kapitull. Do të shpjegoj gjithashtu për Lëvizjen Pacifiste si dhe organizimin e formacioneve të para të armatosura të UÇK-së.

Në kapitullin e dytë, do të përdor tri metoda: empirike, sintetike dhe analitike. Kjo për faktin e saktësimit të hipotezës së parashtruar. Këtu do të shpjegoj periudhën e luftës së UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Si erdhi deri tek sensibilizimi i opinionit botëror për çështjen e Kosovës? Kush ishte Institucioni nga do të fillonte realizimi i ëndrrës së shqiptarëve? Si erdhi deri tek organizimi i Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje? Në mënyrë më të detajuar, dhe nga të

dhënat e autorëve të cilët ishin pjesëmarrës në konferencë, do të shpjegoj negociatat e delegacionit shqiptar, rreth Marrëveshjes kalimtare për Kosovën. Në këtë kapitull do të shpjegoj gjithashtu edhe rolin e personaliteteve kombëtare e ndërkombëtare në konferencë, duke veçuar këtu Sekretaren e Shtetit të SHBA-ve znj. Medeline Ollbrajt, etj.

Në kapitullin e tretë, do të përdor metodën empirike dhe analitike, ku do të shpjegoj kthimin e delegacionit shqiptar në Kosovë, për të marrë miratimin e popullit të Kosovës në mënyrë që marrëveshja të zyrtarizohej. Këtu do të shpjegojë edhe reagimet serbe pas nënshkrimit të marrëveshjes në Paris, si dhe reagime të tjera. Do të shpjegoj gjithashtu se si erdhi deri tek fillimi i operacionit luftarak mbi forcat serbe në Kosovë dhe ish-Jugosllavi dhe kapitullimin e Serbise. Për këto kam përdorur fakte nga burime të ndryshme, kyesisht nga literaturë shqiptare. Informacionin rreth çështjeve të caktuara e kam plotësuar me të dhëna nga mediet e formateve të ndryshme, si dhe intervistave personale që kam patur me personalitete të shquara të Republikës së Kosovës e pjesëmarrës në Rambuje. Kurse thënia se "Shqiptarët dinë t'i fitojnë luftërat por humbin në paqe" ka qenë i gjithë frymëzimi im për zgjedhjen e kësaj teme.

KAPITULLI I:

COPTIMI I TOKAVE SHQIPTARE NGA FUQITË E MËDHA

Paqja e ashpër

Paqja mes Rusisë dhe Turqisë në Shën Stefan, më 3 mars 1878, njihet si paqja më e ashpër e më dramatike mes tyre. Tokat shqiptare u copëtuan mes sllavëve, duke synuar fshirjen e Shqipërisë nga harta gjeografike, si dhe daljen me çdo kusht të Serbisë në Detin Adriatik. Serbët u sollën me një ashpërsi të tmerrshme ndaj banorëve të trojeve që rrëmbyen në vitin 1878, duke ndjekur nga vatrat e tyre mijra banorë të pafaj. Por ata nuk arritën t'i shfarosin shqiptarët, ngase banori i rrënjës nuk shuhet kurrë (Durham, 1998: 332).

Lufta e shqiptarëve e udhëhequr nga Lidhja e Prizrenit i detyroi Fuqitë e Mëdha të ndërrojnë qëndrimin e tyre ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Në Kongresin e Berlinit, më 13 qershor 1878, Abdyl Frashëri me mëndje gjeniu e zemër të madhe shqiptari do të argumentojë shkencërisht e me argumente historianësh lashtësinë e shqiptarëve me rrënjë iliro-pelazge, pra të drejtën e tyre të petjetërsueshme për të jetuar në tokën e vet. ''Ashtu sikur nuk jemi dhe nuk duam të jemi turq, po ashtu do të luftojmë me të gjitha forcat tona, kundër cilitdo që do të kërkonte të na bënte sllav, austriak ose grek'' protestuan krerët shqiptarë (Histori e Popullit Shqiptar, 2002: 159).

Kongresi i Berlinit (nisur nga interesat e pjesëmarrësve në të) i ndryshoi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, megjithatë populli shqiptar mbeti viktima e prerë në thertoren e Europës për të ushqyer fqinjët e pangopur. Nuk u njoh kërkesa për autonomi, e as u kundërshtua copëtimi i tokave etnike, kurse Turqia shqiptarët i la nën mëshirën e fatit dhe interesave të saj. Shpëtimi shihej vetëm duke e shpallur Shqipërinë shtet të Pavarur.

Në rrjedhën e ngjarjeve e mbi supet e shqiptarëve, duke kaluar si mes Purgatori nëpër labirinthet e diplomacive të huaja, Ismail Qemali me shokë më 1912 e shpalli Pavarësinë e Shqipërisë, por gjysma e saj, Kosova dhe pjesë tjera, më vitalet e kombit shqiptar si në vlerë

gjeografie dhe në meritë historie, mbetën jashtë kufijve etnikë. Prerja e një kombi të tillë parahistorik qe tragjedi shekujsh si prerja e Prometheut. Shpallja e shtetit shqiptar pas qindra vjet luftrash e mundimesh të vazhdueshme, ishte megjithatë goditje e fuqishme për shovenët fqinjë që nuk mund të pajtoheshin me idenë e ekzistencës së një shteti shqiptar edhe pse i cunguar. Që nga kjo kohë, si kundërpeshë homerike aspirata e popullit të Kosovës për bashkim me nënën Shqipëri. Mbetet e gjallë në rritje dhe përjetësisht e ndritëshme.

Praktika kriminale e shtetit serb shoqërohej dhe paraprihej me teoritë më çnjerëzore e shpifje të turpëshme kundër shqiptarit. Në prag të Konferencës së Londrës Vladan Gjeorgjeviç, kryeministër serb, botonte famëkeqen "Shqipëris dhe Fuqitë e Mëdha" ku shqiptarët i paraqiste si "njerëz me bisht" (pra, s'kishin të drejtë të rronin si njerëz, aq më keq si shtet, dhe duheshin prerë në mes me thika shovene dhe firma Europe). Europa, kundër zyrtarëve kriminelë shtetërorë pati dhe dijetarë të shquar humanë që nuk pajtoheshin me këto teori, aq më tepër me praktikat kriminale që i shoqëronin. Më 1914 u themelua një komision për të hetuar masakrat që ushtroi Serbia mbi popullin e Kosovës ku raportohet për spastrimin e vërtetë etnik të shqiptarëve. Në raport thuhet: ''Shtëpitë dhe fshatra të tëra ishin bërë hi. Popullata e pafajshme dhe e paarmatosur ishte masakruar...këto ishin masat që ishin zbatuar dhe ende po zbatohen nga ushtria serbe dhe malazeze me qëllim të transformimit të plotë të karakterit etnik të rajoneve të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët'' (Weller, 2009: 72).

Shqiptarët të pakënaqur me kufijtë politikë shtetërorë përcaktuar nga gjashtë Fuqitë e Mëdha më 1913, formulojnë programin e ri kombëtar. Sigurim i pavarësisë e integritetit tokësor të shtetit shqiptar, dhe bashkimin e Kosovës e të gjitha viseve shqiptare të robëruara me Shqipërinë, përbënte thelbin e kësaj platforme. Shpresa se Konferenca e Paqes do të përmirësonte padrejtësitë ndaj shqiptarëve po shuhej. Përkundrazi, ajo legalizoi nga pikëpamja ndërkombëtare copëtimin e mëparshëm të tokave shqiptare, duke mbetur më shumë se gjysma e territorit e pushtuar nga Serbia dhe Greqia. Pra, përderisa më 1913 trojet shqiptare u bënë fli për të "ruajtur" paqen botërore (e që nuk u arrit), më 1919-1920 territore të tjera shqiptare në Konferencën e Paqes po bëheshin kurban për hir të vendosjes së një drejtpeshimi midis fituesve të luftës në pellgun e Adriatikut (Çami, 2007:125).

Shqiptarët e pushtuar

Mbretëria S.K.S (serbëve, kroatëve, sllovenëve) e dalë nga Konferenca e Paqes e që më vonë u quajt Jugosllavi, ishte zotuar se do t'i mbronte interesat e banorëve që dalloheshin si unikë brënda tyre nga raca, gjuha feja e zakonet. Përkundër kësaj, me pabesi të paturpëshme gjithënjë e më shumë shqiptarët i trajtonte si trup të huaj. Ata që në fillim iu nënshtruan reprezaljeve të rënda. Ishin nën mbikëqyrjen e përherëshme të tërë aparatit shtetëror: burgosja, keqpërdorimi dhe çdukja fizike e shqiptarëve ishte në rend të ditës. Shqiptarët e Kosovës nuk kishin asnjë të drejtë për zhvillimin e një kulture kombëtare, duke u ndaluar mësimi apo edhe çdo shkrim në gjuhën shqipe nëpërmjet ligjit diskriminues serb (Reuter, 2003:30).

Nikolla Pashiq (kryeministër i Jugosllavisë i viteve (1919-1926), pat deklaruar se Serbia brenda 20-25 viteve do të arrinte asimilimin e shqiptarëve. Masa e parë për realizimin e këtij plani serbomadh ishte ndryshimi i përbërjes etnike të krahinës së Kosovës. Më 1920, u dha urdhër që Kosova të kolonizohet me kolonë të tjerë sllavë. Nga dhuna shqiptarët detyroheshin të migronin për

në Turqi. Qarqet serbe e malazeze, me ligje e terror këmbëngulnin që shqiptarëve t'u merrej toka. Por edhe pse një pjesë e shqiptarëve (2 milionë shqiptarë janë shpërngulur për në Turqi dhe vise tër tjera) migroi për në Turqi, shumica dërmuese mbeti në Kosovë. (Reuter, 2003:34).

Më 1937 teoricieni vrasës Vasa Çubrilloviq, që u bë i njohur dhe si kreu i Akademisë serbe do të shpallte botërisht: ''Në kohën kur Gjermania mund të përjashtojë me dhjetra mijëra Hebrenj, dhe kur Rusia mund t'i transferojë me miliona njerëz nga njëra pjesë e kontinentit te tjetra, transferimi i disa qindra mijë shqiptarëve nuk do të shkaktojë fillimin e luftës së re botërore'' (Weller, 2009:73).

Terrori mbi shqiptarët vazhdoi

Në emër të një sistemi të ri, fashizmi po synonte ta pushtonte botën. Kjo lindi edhe Luftën e Dytë Botërore. Lufta e përbashkët e UNÇJ si dhe UNÇ të Shqipërisë u shpall si garanci se shqiptarët e Kosovës do t'i realizojnë të drejtat e tyre për vetëvendosje. E drejtë kjo e premtuar nga udhëheqës të PKJ-së si dhe e garantuar me Kartën e Atlantikut. Mirëpo ndodhi e kundërta. Pas luftës Kosova u vendos edhe më përgjakshëm nën regjimin ushtarak serbosllav, duke mos u respektuar lufta heroike e popullit shqiptar, e as vendimet e Këshillit Popullor Nacional çlirimtar për Kosovën të mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 në Bujan të malësisë së Gjakovës. Këtu ishte vendosur për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë sipas Vetvendosjes. Kjo periudhë mori jetën e 45 mijë shqiptarëve, për çka gjatë viteve të '90, kur bijtë më të mirë të popullit kishin marr pushkën për çlirimin e plotë të Kosovës, Millosheviqi me ironi cinike në bisedë më gjeneralët e NATO-s Klark dhe Naumann do të thoshte: "Ne do t'i qetësojmë shqiptarët si në vitin 1945...." pyetjes se për çfarë zgjidhjeje e kishte fjalën Millosheviqi iu përgjigj: ''I Vramë. I vramë të gjithë. Kjo punë zgjati disa vjet, por i vramë të gjithë. Dhe nuk patëm më asnjë shqetësim'' (Petritsch, 2002:143).

Edhe pas rënies së fashizmit Kosova nuk u bë e lirë. Udesh prapë përforcimi i qëndresës nëpërmjet subjekteve ilegale të prira nga atdhetarë të shquar vetëflijues si Shaban Polluzha, Ajet Gërguri, Marie Shllaku, Kadri Halimi, Adem Demaçi, Mehmet Hajrizi etj. E rëndësisë së veçantë është Lëvizja Studentore e vitit 1968 e prirë nga Osman Dumoshi. Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë përkonin me rrëzimin e De Golit në Francë. Kurse fryma reformiste që kishte përfshirë Jugosllavinë e viteve të '60-ta i dha fund satrapit Rankoviç, i cili në aksionin e tij të njohur për mbledhjen e armëve në Kosovë torturoi 30.000 shqiptarë, vdiqën 1000 vetë e mijëra të tjerë mbetën invalidë (Hajrizi, 2008:30).

Demonstratat e vitin 1968 erdhën nga e kaluara si shkallëzim i rrufesë nisur nga shpirti i Kosovës së vuajtur e të pamposhtur. Ato përfunduan me nxjerrjen e kushtetutës së vitit 1974, me çka shqiptarët përfituan disa të drejta por jo në nivelin e kërkesave të parashtruara. Edhe pse Kosova ishte e treta për nga madhësia, dhe ishte element konstituiv i Jugosllavisë, kushtetuta e përkufizonte si pjesë të Serbisë. Politika shoviniste serbe bënte plane për rishikimin e kësaj kushtetute. Kjo ishte edhe arsyeja e formulimit të "Librit të kaltër" i vënë në qarkullim qysh në vitin 1976, për t'u bërë publik më 1989. Në këtë libër flitej për favorizimin e statutit të Serbisë. Popujt e Jugosllavisë kishin shfaqur rezerva ndaj tij, andaj dhe u botua më 1990, atëherë kur planet serbe si politikisht ashtu edhe juridikisht i afroheshin greminës së fundit (Instituti, 2006: 21).

Pas vdekjes së Titos ideologjia komunisto-shoveniste gjithnjë e më shumë u zëvendësua nga

nacionalizmi serbomadh. Si mundësi e re shpëtimi, parashihej që të gjitha territoret e banuara me serbë, në rast nevoje edhe me përdorimin e dhunës dhe dëbimit të grupeve të tjera etnike, të bashkoheshin në një shtet të vetëm serbomadh (Fischer, 2008: 98). Serbia, me politikën e saj fashiste po përgatitej për ta vënë në zbatim "Librin e Kaltër" dhe suprimuar autonominë e Kosovës, status ky që shihej i tepruar, madje në dëm të lirive e të drejtave të serbëve!!! (Akademia e Shkencave 1999: 125). Kundërshtimi i kësaj politike filloi me demonstratat e 11 marsit 1981. Viti 1981, është viti më i përgjakshëm i rinisë kosovare, ashtu siç është edhe kthesa më e madhe për mbarë popullin e Kosovës dhe rajonin në përgjithësi. Pikërisht ngjarjet e vitit 1981 e filluan krizën e shtetit jugosllav e dhjetë vite me vonë do të pasoi edhe shperberja e tij (Vukaj, 2007:146). Qëndresa burrërore e Kosovës qe uverturë lirie për tërë popujt e shtypur nga Serbia të Jugosllavisë. Ajo qe pika kulmore e zikzakut të rrufesë që do t'i binte tmerrshëm mbi krye sundimit të paduruar serb.

Demonstratat vazhduan me vrull edhe më 26 mars, 1, 2 dhe 3 prill, duke u mbytur në gjak nga policia dhe ushtria jugosllave, kurse numri i të keqtrajtuarve dhe të burgosurve, kishte arritur shifrën marramendëse. Ajo ishte rreth 600.000, shifër kjo tepër e madhe për popullin 2 milionësh të Kosovë. Regjimi serbosllav keto demonstrata i perdori si casus belli për vënien e orës policore, arsye të pushtetit ushtarak në Kosovë, për ta vrarë e burgosur rininë dhe inteligjencën e saj. Por përkundër shtypjes së përgjakshme të kryengritjes së vitit 1981, koha na e ka vërtetuar se kjo ishte vetëm fillimi i luftës së pandërprerë dhe finale të popullit shqiptar të Kosovës drejtë fitores së sigurt (Hajrizi, 2008: 195). Edhe njëherë Kosova shfaqej me dinjitet madhështor lirie, ashtu siç e ka përcaktuar shkrimtari Agim Shehu: "Nëse kombi shqiptar është një kometë, Kosova është koka e ndritëshme e kësaj komete".

Suprimimi i autonomisë së Kosovës

Pas ngjarjeve të vitit 1981, statusi shoqëror- politik e juridik i shqiptarëve erdhi duke u rudhur. Ky fenomen u bë më i dukshëm sidomos pas ardhjes së Sllobodan Millosheviqit si president i Serbisë më 1985, i mbështetur nga forcat nacionaliste më reaksionare serbe. Millosheviqi i inkurajuar nga heshtja e Evropës dhe e republikave të tjera të ish Jugosllavisë ndaj problemit të Kosovës, si dhe për të arritur autoritetin e tij politik, me parullën se ''krahinat autonome janë dy kancere në gjirin e republikës së Serbisë'' rindezi emocionet e vjetra nacionaliste serbe (Akademia e Shkencave, 1999:126). Më 23 mars 1989, nën kërcënimin e armëve dhe të votave të joparlamentarëve, Parlamenti krahinor (tanimë serb) shfuqizoi statusin autonom të Kosoës. Ky ishte edhe një fillim i politikës brutale të shtypjes së popullit shumicë shqiptar (Fischer, 2008:99). Pas kësaj u rrëzua e gjithë struktura institucionale politike, ekonomike, gjyqësore, shëndetësore e kulturore autonome e Kosovës dhe gjithçka u vendos nën pushtetin e Beogradit (Akademia e Shkencave, 1999:127). Ndërsa në fillim të vitit 1989 në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme, ku u pasqyrua një dhunë e pakontroll e aparatit serb kundër popullit shumicë shqiptar. Shqiptarët kundër masave shtypëse të Serbisë u përgjegjën me rezistencë paqësore (Fischer, 2008:99).

Lëvizja Pacifiste

Lëvizja demokratike që po frymonte nëpër botë jehoi fuqishëm në Kosovë, pasi aty kish si askund gjak e rënkime të popullit brënda vetes. Shqiptarët nëpërmjet formimit të partive të para

legale në Kosovë më 1989-1990, shpresuan në të drejtat e tyre nëpërmjet proceseve demokratike si pjesë Europe. Por, përderisa disa nga republikat e ish-Jugosllavisë e kishin shpallur pavarësinë, liria dhe pavarësia në Kosovë mendohej të realizohej nëpërmjet rrugës paqësore me një padëgjueshmëri të lehtë qytetare, pa kundërshti aktive, pa luftë çlirimtare. Krijimi i një ndjenje të tillë krijonte një lehtësi shpirtërore dhe iluzione të paqëndrueshme në anën tjetër. (Buja,2007:273).

Pacifizmi i llojit të tillë mendonte se problemi shqiptar do të zgjidhet me rënien e ndryshimeve ideologjike në shkallë globale, dhe me demokratzimin e rendit politik, në ish-Jugosllavi (Akademi e Shkencave, 1999:131). Kësaj fryme i printe Ibrahim Rugova, herë herë, për mendimin tim, me një politikë jo gjithmonë e gjithkund të frutëshme përballë një armiku kokëfortë në çdo qëndrim të tij. Ndoshta sedra politike, dëshira që të jetë sa më karizmatik para popullit, e të ngjajë me një president perëndimor, ka bërë që ai çdo here të ketë një paraqitje dhe të lexueshme dhe të pakuptueshme. Shumë rreth tij mendonin se nuk kanë nevojë të dinë pasi "i di të gjitha kryetari" por në fakt ai nuk ka ditur asgjë (Hysa, 2004:139).

Edhe përcaktimi i shpeshtë i Rugovës si ''Gandi i Ballkanit'' është i pavend. Koncepti paqësor i Gandit mbështetej në bindjen se ''e vërteta'' duhet kërkuar me të tjerët dhe qoftë edhe duke qenë i shtypur egërsisht. Kurse versioni i qëndresës paqësore përkundrazi iu përshtat gjendjes mbizotëruese, në të cilën një kryengritje e armatosur do të kishte qenë e pashpresë (Petritsch, 2002:65). Ismail Kadare e akuzonte Rugovën dhe LDK-në për qëndrim të frikur që sillte një mënyrë të vepruari politikisht të rrezikshme (Petritsch, 2002:84).

Nga diplomatët perëndimor bëhej përpjekje formash të ndryshme për ta lëvizur më drejt "kolosin e brishtë" siç e cilësonin Ibrahim Rugovën analistët perëndimorë. I jepnin mendime dhe e rrethonin me politikanë e intelektualë të tjerë për t'i shtyrë bashkë përpara proceset, Por Rugova mund të krahasohej me një bimë disi pasive (kështu thoshte Gelbardi). Rugova qëmoti s'lëvizte vendit pa u "ujitur" kohë pas kohe prej diplomacisë perëndimore, në radhë të parë asaj amerikane (Shala, 2001:37). Megjithatë, duhet pranuar dhe tjetra, që fitimtarët nuk gjykohen.

Lëvizja pacifiste zgjidhjen e çështjes së Kosovës e shihte pikësëpari nëpërmjet informimit të opinionit ndërkombëtar për dhunën e aparatit serb, përmes konferencave të shtypit, vizitave jashtë vendit apo takimeve me media. Kurse në rrafshin institucional LDK organizoi institucione paralele: Parlamentin, Qeverinë në ekzil, QIK si dhe mekanizma tjerë parashtetërore. Kështu, institucionet zyrtare të kontrolluara nga serbët, bashkekzistonin me organizma jozyrtare të kontrolluara nga shqiptarët. (Albright, 2003:443). Dhe kjo megjithatë nuk ishte pak. Fundi i ngjarjeve i dha të drejtën që i takon.

LDK-ja më 1992 organizoi edhe zgjedhjet, të cilat nuk i plotësonin standardet demokratike. Në këto zgjedhje ajo do të fitonte 76% të votave. Në zgjedhjet presidenciale të zhvilluara në të njëjtën kohë kandidati i vetëm Ibrahim Rugova fiton 99,5% të votave (Petritsch, 2002:72). Me këtë mori edhe primatin moral në të gjitha poret e jetës politike dhe shoqërore në Kosovë. Kurse pushtetit faktik do të mbetej në duart e aparatit shtetëror serb, i cili do ta toleronte veprimin e LDK-së, dhe të partive të tjera politike, të cilat më shumë i ngjanin një dekori demokratik për LDK-në. Kurse Qeveria në ekzil do të propagandojë me të madhe se lufta eventuale në Kosovë "do të sillte viktima më të mëdha se në Bosnje" etj. (Instituti, 2006:55).

Marc Weller në librin e tij shkruan se ishte pikërisht vendimi i qeverisë së Rugovës që vendosi për të mos financuar UÇK-në duke nxitur edhe tensione kombëtare. Por me përhapjen e luftës, UÇK-ja kishte themeluar strukturën e vet për mbledhje fondesh si në Evropë ashtu edhe në SHBA (Weller, 2009:140). Një fushatë e ashpër kundër luftës çlirimtare u zhvillua edhe nga mjetet e informimit të kontrolluara nga LDK-ja, e sidomos nga Bujar Bukoshi. Ky qëndrim filloi të zbutej vetëm pas Konferencës së Rambujesë. Pas disa viteve Bujar Bukoshi në një intervistë dhënë Shkëlzen Gashit do të deklarojë: "..Qeveria ime gjatë 10 viteve të punës së saj i ka bërë ndoshta mbi 100 gabime apo lëshime, unë jam i vetëdijshëm për këtë..." (Gashi, 2004:59).

Serbia duke patur në dorë endse dhe gurin dhe arrën, me ndihmën e një politike shtypëse e mashtruese arriti t'i dëbojë nga Kosova mbi 400.000 vetë. Politika e rezistencës pacifiste tanimë ishte bërë pengesë e ecjes përpara drejt lirisë. Krijimi i UÇK-së dhe dalja publike e saj filloi të ringjallë shpresën te populli se edhe shqiptarët mund t'i dalin zot fatit të tyre, siç thotë një dijetar: "Tiranët duken të mëdhenj kur skllavi u rri në gjunjë. Ngreu lart, dhe ai është i vogël".

Opinioni publikë ndërkombëtar, krismat e pushkëve në Kosovë i vlerësoi si një vazhdimësi e çlirimit të popujve të ish-Jugosllavisë nga hegjemonizmi serbosllav. Kështu, mediat e huaja si Uashington Post për UÇK-në shkruante: "Është ngritur aq sa mund ta dëmtojë shumë ushtrinë jugosllave" kurse administrata amerikane UÇK-në e njohu si bashkim "luftëtarësh të lirisë". Për fat të keq lideri i LDK-së UÇK-në e etiketonte si krijesë të sherbimit sekret serb. Etiketimi i tillë u shkonte për shtati edhe disa qeverive të huaja si Rusisë, e veçanërisht Serbisë të cilat me çdo kusht donin ta izolonin ndërkombëtarisht UÇK-në. Kjo strategji ishte menduar, në mënyrë që UÇK-ja të mos ishte në pozitë për të marr pjesë në negociata (Weller, 2009:159).

Bëhej përpjekje maksimale që të lihej Beogradi t'ia tregonte qejfin UÇK-së. Këtë më së miri na e argumenton ministri i Jashtëm gjerman Joshka Fischer i cili në librin e tij shkruan se, gjatë bisedave që kishte pasur me Millosheviqin në Beograd, ai vazhdimisht i kthehej UÇK-së, duke dëshiruar të dinte se përse po i përkrahte Perëndimi? Ata janë ''vrasës, banditë dhe dhunues'' me të cilët do të kryente punë brenda 14 ditëve (Fisher, 2008:145).

Kosova ndër rrjetat e marrëveshjeve

Në Konferencën e Hagës per ish-Jugosllavinë me 1991 ku dhe u vulos shpërbërja e saj, Kosova nuk u trajtua si pjesë konstituive e shtetit jugosllav, edhe pse dihej abrogimi i njëanshëm i statusit të saj bërë më 24 shkurt 1989 nga Parlamenti serb. Nga kjo konferencë doli edhe Komisioni i Banditerit i cili Kosovën nuk e llogariti as si term gjeografik e lere më si njëri nga tetë subjektet që kanë përbërë ish-Federatën Jugosllave (Buja, 2007:450) Komisioni i Banditerit padrejtësisht e

injoroi çështjen e Kosovës duke pranuar aneksimin e dhunshëm nga Serbia, edhe pse rrjedhat e ngjarjeve të mëtejme e bënë të pa vlefshëm këtë vendim (Tahiri, 2001:17). Në të kundërt, Katër ish republikave jugosllave, Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës e Hercegovinës dhe Maqedonisë iu njoh subjektiviteti shtetëror.

Konferenca e Londrës që vazhdoi punimet në Gjenevë (1992-1995) shqiptarët i shqyrtoi vetëm aq sa ju deshën asaj për informacion burimor. Aty merrnin pjesë pesë Delegacione Shqiptare (delegacioni nga Shqipëria, si shtet fqinjë i Jugosllavisë, delegacioni nga Kosova, delegacioni nga Lugina e Preshevës, delegacioni nga shqiptarët e Malit të Zi, dhe delegacioni nga shqiptarët e Maqedonisë (Buja, 2007:103). Ibrahim Rugova kishte marrë një leter nga organizatorët e Konferencës, që do të mbetet unikale në historinë e diplomacisë, ku ndër të tjerat thuhet:

'Nëse planifikoni të vini në Londër në kohën e Konferencës (26-28 gusht), atëhere jam i lumtur t'ju informoj se do të jetë e mundur për ju dhe delegacionin tuaj që të keni qasjen në qendrën e konferencave, me që nuk do të jetë e mundur që t'i mundësojmë delegacionit tuaj qasjen në vetë sallën e mbledhjeve. Organizatorët do të sigurojnë sallone dëgjimi ku do të transmetohet zhvillimi i Konferencës zyrtare në mënyrë të drejtëpërdrejtë'' (Weller, 2009:103).

Shqiptarët e pritën me zhgënjim të hidhur rolin që u ishte caktuar në Londër (Petrisch,2002:78). Kosova mori pjesë në Konferencë me atë që u njoh si ''dhoma-jehonë'', por pa ndonjë angazhim thelbësor për çështjen e saj. Kjo kishte për qëllim që më vonë të bartet si problem minoritar në Konferencën e Gjenevës. Ky injorim u ndje edhe më thekshëm në Konferencën e Paqes në Dejton më 1995. Mosshqyrtimi i çështjes shqiptare edhe në këtë Konferencë ishte një injorim por edhe nënçmim i faktorit shqiptare në Ballkan, edhe përkundër asaj se Kosova ishte deklaruar në favor të ruajtjes së integritetit territorial të shteteve fqinje duke hequr dorë nga pretendimet territoriale si p.sh. në raport me Maqedoninë, si dhe duke përjashtuar agjendën panshqiptare, e duke kërkuar pavarësinë në vend të bashkimit me Shqipërinë (Weller, 2009:61).

Millosheviqit iu lejua që të nënshkruajë marrëveshen e Daytonit në emër të serbëve të Bosnjës, duke përcaktur kështu personalisht, fatin e saj të mëtejmë në atë Konferencë. Ndërkohë kishte kërcënuar me mosvajtje në Konferencën e Paqes në Dejton po qe se aty do të flitej edhe për Kosovën (Buja, 2007:275).

Nga ana tjetër Millosheviqi në emër të Jugosllavisë së cunguar në Deyton parashtronte zgjerimin e Serbisë, ide kjo, që nga lëvizja, ''Dora e zezë'' apo ''Unioni i vdekjes'' themeluar më 1882 nga mbretëria serbe për të krijuar Serbinë e madhe me dalje në Adriatik. Millosheviqi parashtroi kërkesën që territoret e banuara kryesisht me serbë në Kroaci e Bosnje-Hercegovinë, do të duhej të shkëputeshin. Serbia pretendone se cilado popullatë serbe do të duhej ta kishte të drejtën të shkëputej nga etnitetet e posapavarësuar, argument ky që u kundërshtua nga Komisioni i Banditerit i cili u themelua për ta këshilluar Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për çështjet e pranimit të shtetësisë dhe të trashëgimisë (Weller, 2009:58) Tani shqiptarët e Kosovës, po i hidhnin sytë përqark me dhimbje e habi, duke parë shtetet e pavarura të krijuara. Këtu dhe filloi humbja e durimit, teksa shihej qartë mohimi i të drejtave të shqiptarëve, shkruan Medeline Olbrajt në librin e saj (Albright, 2003:443).

Kjo ishte traumë për shqiptarët, pasi u vërtetua se politika e Rugovës për qëndresë pasive

kishte dështuar. Dhe jo vetëm kaq, por edhe ideja e tij, që ata do të "shpërblehen" nga vendet perëndimore për "sjelljen e tyre të mirë" kishte qenë krejtësisht e gabuar. (Judah, 2002:159).

Përmbyllja e marrëveshjes së Daytonit pa u përmendur Kosova, dëshmoi haptazi dështimin e rezistencës pasive. Në vend të shpërblimit për veprim të përgjegjshëm siç ëndërronte Rugova, Kosova u injorua plotësisht. Kështu më 1996 në pyetjen që iu bë z. Rudolph Perina, shef i Misionit diplomatik të SHBA-ve në Beograd, dhe pjesëmarrës në Konferencën e Dayton-it, se pse Kosova nuk u ftua në këtë Konferencë, ai do të përgjigjet: "Në Dayton janë ftuar ata që kanë luftuar". Me këtë u bë më se e qartë: Bota dëgjon vetëm krismën e pushkës! (Shala, 2001:22).

Nuk ishte gjë e mirë që Marrëveshja e Dejtonit nuk e përfshiu Kosovën. Një pakicë serbe në Kosovë nuk mund të sundojë 90% të shqiptarëve atje (Milo, 2009:31). Mospërfshirja e Kosovës në Marrëveshjen e Daytonit vetëm sa ka hapur shtegun për luftën e ardhshme, do të shprehet Joshka Fischer në librin e tij (Fischer, 2008:100). Kurse Vollfgang Petritsch në librin e tij gjykon se përllogaritjet e bashkësisë ndërkombëtare në Dayton, për mos përfshirjen e Kosovës në këtë konferencë ishin fatale, duke vërë në rrezik edhe baraspeshën e brishtë të fuqive të mëdha (Petritsch, 2002:80).

Formacionet e armatosura të organizimit ushtarak

Lëvizja çlirimtare, si lëvizje përbashkuese e të gjitha formave të rezistencës aktive, ka qenë vijimisht e pranishme në jetën e shqiptarëve të Kosovës. Qysh në mesin e viteve të '80 në perëndim ekzistonte një organizatë me ndikim në mërgatën e re shqiptare e njohur me emrin LPK (Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës), e cila trashëgonte mendimin për bashkim të ri të shqiptarëve. (Akademia e Shkencave, 1999:132).

Më 1992 lëvizja çlirimtare tani shquhej me aksione të njëpasnjëshme kundër milicisë serbe të vendosur në Kosovë. Aksionet e para të UÇK-së, janë të lidhura me fundin e vitit 1992 dhe fillimin e vitit 1993. Komunikatat e aksioneve të para të UÇK-së nuk janë botuar në shtypin shqiptar, deri në komunikatën e 20-të. Në Beograd UÇK-ja u cilësua si ''forcë terroriste''. Përderisa më 1996 ''Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së botonte një buletin, në të cilin njihte aksionet e veta dhe botonte komente për ngjarjet politike të ditës (Petritsch, 2002:86). Rugova e quajti UÇK-në si shpikje serbe. Por ishte Adem Demaçi ai i cili pranoi për herë të parë në dhjetor 1997 ekzistencën e UÇK-së (Petritsch, 2002: 88).

Ofensiva e parë serbe kundër UÇK-së filloi në mars të të vitit 1998, të udhëhequra si ''Luftë etnike'', sipas modelit të luftërave në Bosnjë dhe Kroaci. Si pasojë e këtyre ofensivave e sipas të dhënave të OKB-së, në vjeshtën e vitit 1998, në Kosovë në arrati ishin 230 mijë njerëz. Jo luftë kundër UÇK-së, por parasëgjithash terrorizmi dhe dëbimi i popullatës shqiptare ishin qëllimi i vërtetë i luftës. Përbërja etnike në Kosovë duhej të ndryshonte përgjithëmonë, dhe kjo mund të bëhej vetëm me terror dhe dhunë brutale, gjë që e parashihte edhe programi serbomadh (Fischer, 2008:100).

UÇK përshkoi një rrugë të mundimshme të rritjes, derisa në mars të 1989, mori përpjestime të gjera. Nga qarqe të jashtme të caktuara antishqiptare u cilësua me emra të ndryshëm si: ''Grupim njerëzish të frustruar'', ''që i ka bashkuar dëshpërimi'' etj. Por UÇK-ja u njoh për herë të parë si

bashkim ‘’luftarësh të lirisë’’ nga administrata politike amerikane. Zëdhënësi i parë i UÇK-së, një nga figurat e shquara edhe më herët në publik u bë Jakup Krasniqi (Akademia e Shkencave, 1999:35). Lufta e drejtë dhe e vendosur e UÇK-së i dha asaj legjitimitetin ndërkombëtar, duke e bërë faktor vendimmarrës, dhe si lëvizje ndërkombëtarisht të pranuar (Tahiri, 2001:23).

UÇK-ja u bë katalizator i ngjarjeve në Kosovë. Ajo përshpejtoi përceptimin e krizës, më shumë se kurrë ndonjëherë për një zgjidhje reale dhe afatgjate (Milo, 2009: 72). Çeta e parë ishte ajo e Llapit, si guerilja e parë me organizim ushtarak në shekullin XX. Fillimisht, njerëzit e angazhuar në UÇK ishin të pakët, ata më të devotshmit, më trimat, më sakrifikuesit, më të ndërgjegjshmit, kryesisht anëtarë të LPK-së (Buja, 2007:313).

Siç thamë Kosova më 1992, e kishte formacionin e parë të armatosur, me komandant Adem Jasharin në Prekaz. Kulla e Shaban Jasharit ishte strumbullari rreth të cilit do të lidhen të gjitha formacionet e armatosura. (Krasniqi, 2006:20). Bashkërendimi i sulmeve të armatosura, shtrirja e UÇK-se dhe aksionet e suksesshme mbi mlicinë armike ishin fryt i punës dhe ëndërr e komandantit Adem Jashari. Më 5, 6, dhe 7mars 1998 rrethimi i shtëpisë së tij nga ushtri e polici serbe, ishin vendimtare për jetën e komandantit. Kjo është edhe epopeja më e madhe dhe më e lavdishme por edhe më tragjikja e UÇK-së. Rënia e Komandantit Legjendar, flijimi familjar i Jasharëve legjendarë hapën një epokë të re të lavdisë e të tragjedisë në historinë tonë të re. (Krasniqi, 2006:24).

Përderisa bota prirej nga frymë demokratike të integrimeve mes popujve, Serbia, me metoda fashiste e gjenocidiale synonte të materializohej nëpërmjet planeve të Grashaninit e Çubriloviçit duke çfarosur shqiptarët. Vrasjet serbe në Kosovë të sillnin ndër mend vrasjet në Bosnje (Clinton, 2005:712). Por tani më njësitë e UÇK-së kishin zënë malet. Bijtë më të mirë të Kosovës po i fitonin betejat me gjakun e tyre. U krijuan edhe zonat e para të lira, nga u dëgjua për herë të parë zëri i Kosovës së Lirë. Në pamundësi për t’u përballur me UÇK-në ushtria serbe vriste me cinizëm krimineli njerëz të pafaj, digjnin e shkatërronin çdo gjë që ishte shqiptare. Bijtë e UÇK-së u kujdesën për popullin e mbetur nën qiellin e hapur. Krismat e pushkës i dëgjoi bota. Kjo përshpejtoi ardhjen e delegacioneve ndërkombëtare për t’u njohur drejtpërsëdrejti me luftën në Kosovë. SHBA-të, BE, apeluan në ndërprerjen e represionit serb. U nënshkrua edhe marrëveshja Millosheviç-Hollbruk, më 13 tetor të vitit 1998 në Beograd, që u përcaktua si pikë e mundshme kthese të krizës (Petritsch, 2002:129).

Marrëveshja e përbërë prej 11 pikave kishte mbështetje të plotë të NATO-s dhe të Grupit të Kontaktit, përfshirë edhe Rusinë. Për shumë arsye kjo konsiderohet si një e arritur shumë e madhe. Sipas kësaj marrëveshjeje, hapsira ajrore e Kosovës do të kontrollohej nga NATO. Si kurrë ndonjë herë në Kosovë do të veprojnë 2.000 vëzhgues të OSBE-së. Do të kthehen refugjatët shqiptar, si dhe do të fillonte procesi politik për zgjidhjen e problemit (Vukaj, 2007:193).

Gazeta ruse ‘’Njezavisimaja Gazeta’’, në një artikull të saj të datës 27.10.1998, thekson për deklarimet e gjeneralëve Klark dhe Nauman, lidhur me sigurinë e vëzhguesve, të cilët ua kanë bërë të qartë Millosheviqit se ata do të mbrohen nga aviacioni i NATO-s (Vukaj, 2007:201). Marrëveshja lejonte edhe ardhjen e misionit diplomatik ndërkombëtar KDOM, që vepronte nën udhëheqjen politike të ambasadoreve të Grupit të Kontaktit, të ambasadorit Austriak, nw Beograd, pasi Austria kryesonte BE-në. Nëpërmjet burimeve të intelegjencës si dhe të burimeve tjera, KDOM do të kuptonte për zonat e tashme apo të ardhshme të luftimit, përfshirë edhe mizoritë kundër civilëve

(Weller, 2009:160). Pas Marrëveshjes Millosheviq-Hollbruk KDOM-i u shndërrua në Mision Verifikues të Kosovës (Petritsch, 2002:110).

Derisa mendohej për respektimin e armëpushimit serbët me pabesi ndërmerrnin ofensiva gjakësore kundër popullatës në Kosovë. Thuhet se mosrrespektimi i marrëveshjes ishte si pasojë e mos përfshirjes së UÇK-së, në këtë marrëveshje (Fisher, 2008:116). Kjo ishte edhe pika më e dobët e kësaj marrëveshjeje (Petritsch, 2002:140). Në këtë kohë arrestohen tetë ushtarë serbë, nga njësitet e UÇK-së të cilët u liruan vetëm me ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve, dhe duke i kushtëzuar me lirimin e ushtarëve të UÇK-së. Kjo ishte fitore e madhe për UÇK-në pasi Serbia u detyrua ta pranojë si palë UÇK-në edhe para ndërkombëtarëve. Për këtë në librin e tij Jakup Krasniqi do të shkruante: "... Ky rast ka qenë një ndër më të rëndit në jetën time; po mos të liroheshin ushtarët e UÇK-së, kisha vendosur të jepja dorëheqje..." (Krasniqi, 2006:155).

Raçaku krim kundër njerëzimit

Marrëveshja Millosheviç-Hollbruk asnjëherë nuk u respektua. Për Beogradin krimi qe në harmoni me pabesinë. Kulmi i shkeljes së marrëveshjes për armëpushim është më 15 janar 1999, kur ushtarët serbë para syve të botës bënë masakrën më çnjerëzore, Masakrën e Reçakut, duke vrarë në mënyrën më makabre 45 gra, pleq e fëmijë. Për këtë para opinionit publik Z. Uliam Vokeri, kryesues i misionit verifikues të OSBE-së në Kosovë, do të deklarojë: ¨Ky është krim kundër njerëzimit¨ (Krasniqi, 2006:131).

Lufta mes Kosovës e Beogradit ka hapur varre të shumta, Prekaz, Rahovec, Kodra e Polacit, malet e Kleqkës e vende të tjera, por masakra e Reçakut do të mbetet dëshmi e përjetshme e krimit serb në Kosovë (Myrtaj, 2002:55). Ekzekutimet e civilëve ishin instrument i strategjisë serbe ''kundër kryengritjes'' në Kosovë, për ta detyruar popullatën që të arratisej, për t'ia mohuar kështu njëkohësisht përkrahjen UÇK-së (Fischer, 2008:120). Masakra e Reçakut të gjithëve po u sillte në mëndje, e para syve, tmerret e luftës në Bosnjë, Srebrenicë e ngjarje të tjera tepër të kobshme (Milo, 2009:133). Ky ishte edhe argument se dhuna serbe në Kosovë kishte marrë formën klasike të një gjenocidi të egër dhe primitiv (Akademia e Shkencave, 1999:140).

Zonja Olbrajt në një bisedë telefonike me ministrin e Jashtëm Joschka Fischer, kishte propozuar reagim të ashpër dhe takim urgjent të Këshillit të NATO-s, për çka ishin pajtuar Cook dhe Vedrin (Fischer, 2008:122). Këshilli Sigurimit, në Deklaratën e 19 janarit 1999, e dënoi masakrën dhe bëri thirrje për...''nevojë urgjente dhe hetim të plotë të fakteve, duke ftuar urgjentisht që RFJ-ja të bashkëpunonte me Gjykatën Ndërkombëtare për krime lufte (Mahmutaj, 2002:20). Krimet kundër njerëzimit nuk mund të kualifikohen kurrë si punë të brendshme të një shteti (Blair, 2005:40).

Në anën tjetër përderisa bota po e dënonte krimin e rëndë në Raçak, qeveria serbe mori vendimin që ta përzënë nga Kosova U. Uoker, për çka do të ''qortohet'' edhe nga Rusia. Shpallja e U.Uoker si person nongrata, mund ta destabilizojë edhe më shumë situatën në Kosovë, do të deklarojë Ministri e Punëve të Jashtme Ruse (Vukaj, 2007:235). Vrasja e banorëve paqësorë, (po të jetë kështu) është një egërsi e përbindëshme që meriton të dënohet rreptë. Në Kosovë duhet të shkojnë hetues ndërkombëtarë, pavarësisht se Beogradi është kundër. Më mirë ata se sa Avionët e NATO-s - do të shkruan gazeta ''Komersant'' e datës 19 janar (Vukaj, 2007:238).

Reçaku heroik dhe tragjik ishte një kthesë e madhe për Kosovën. Ndërkombëtarët tanimë të involvuar në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, nuk mund ta mohonin kriminalitetin e ushtrisë serbe. Masakra e Racakut përfundimisht e përjashtoi mundësinë e një marrëveshjeje për paqe në bisedime të drejtëpërdrejta shqiptaro-serbe, siç ishte propozuar për disa vite me radhë. Pas kësaj masakre u rrit aktiviteti diplomatik në relacionin Uashington-NATO-Bruksel-Grup i Kontaktit, ku dhe të gjithë kishin arritur pajtimin se ideja për organizimin e një Konference duhej të kishte prioritet ndaj politikës së ultimateve (Fischer, 2008:123).

Më 29 janar 1999 Grupi i Kontaktit, i takur në Londër në Pallatin Lancaster House, në afërsi të Pallatit Mbretëror St.James, doli me Deklaratën historike për mbajtjen e Konferencës në Rambuje, dhe miratoi parimet e panegociueshme, mbi të cilat duhej të ndërtohej Marrëveshja Kalimtare për Kosovën (Tahiri, 2001:54). Më 30 janar Këshilli i NATO-s e ripërtëriu vendimin e marr në tetorin e vitit të kaluar, duke vendosur kështu korrnizë diplomatike për Konferencën (Fishcer, 2008:131).

Fryma e Deklaratës së Grupit të Kontaktit nuk la vend dyshimi në vendosmërinë për të gjetur një zgjidhje e për të negociuar para pranverës. Është gati ultimatum, do të shprehet në librin e tij Paskal Milo (Milo, 2009:138). Gjithësesi ky hap u përshëndët nga shqiptarët. Sipas Qosjes ‘’Kosova në Rambuje do të thotë Kosova në Perëndim, e Kosova në Perëndim do të thotë Kosova jashtë Jugosllavisë’’ (Akademia e Shkencave, 1999:140).

Në Beograd natyrshëm deklarata e Grupit të Kontaktit nuk është pritur mirë (Milo, 2009: 139). Shqipëria zyrtare nëpërmjet ambasadorit të saj në Francë, Luan Rama kishte kërkuar nga këshilltari i posacëm i Vedrinit, i ngarkuari për Kosovën, që Shqipërisë t’i jepej statusi i vëzhguesit, gjë që nuk u pranua. Si arsyetim këshilltari Fushe do të deklarojë se nuk do të ketë vëzhgues të tjerë nga Ballkani, dhe se në Rambuje nuk do të ketë konferencë ndërkombëtare si ajo e Parisit për Bosnjen (Milo, 2009:141).

Vendosmëria për ndërhyrje ushtarake

Grupi i Kontaktit i përkrahur nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, bashkë me NATO-n tani më ishin pjesë e lojës. Qeveria amerikane në veçanti kishte filluar të bënte trysni për aksion të mundshëm ushtarak për ta ndalur represionin në Kosovë. Kërcënimi i përdorimit të forcës në raport me Kosovën nga SHBA-ja ishte bërë që nga viti 1992. ‘’Në rast të konfliktit në Kosovë, i cili do të shkaktohej nga veprimi i Serbisë, SHBA-ja do të ishte e gatshme të përdorte forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në vetë Serbinë’’, i kishte shkruar kryetari i atëhershëm, Gjeorge Bush, Sllobodan Millosheviqit, kërcënim ky që u përsërit nga administrata e Clintonit (Weller, 2009:171). Kurse Javier Solana kishte deklaruar se Aleanca, në përpjekjet e veta për ta përkrahur bashkësinë ndërkombëtare që të arrihej një marrëveshje e negociuar, kishte: ‘’....rishikuar planifikimin ushtrak për një vistër mundësish që të ndalej dhuna dhe të krijoheshin kushtet për negociata. Këto e përfshijnë edhe përdorimin e forcave tokësore e ajrore, e posaçërisht një vistër të gjerë opsionesh për përdorimin vetëm të forcës ajrore. Këto sigurojnë që NATO-ja të mund të vepronte me shpejtësi dhe në formë efikase po të shfaqej nevoja’’(Weller, 2009:160).

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, kishte miratuar edhe rezolutat 1160 (1998), sipas së cilës Beogradi duhej të ndërpriste të gjitha veprimet luftarake, si dhe 1199 (1998), që ishin të bazuar në kapitullin e VII të Kartës së OKB-së. Një rozolutë e cila merret duke u mbështetur në Kapitullin e VII të

Kartës së OKB-së, çmohet si hap i parë drejt masave më të ashpra të ndërmarra nga K.S. të cilat mund të shkojnë deri te intervenimi ushtarakn (Fischer, 2008:101). Në bazë të kapitullit VII të Kartës së OKB-së, keqësimi i gjendjes në Kosovë u cilësua si ‘’rrezik për paqe dhe siguri në rajon’’ (Petritsch, 2002:121). Edhe ministri i Jashtëm rus Ivanov, votoi pro Rezolutës 1199, çka nënkupton një tërheqje nga pozicioni i saj i fortë në mbështetje të Beogradit. Para opinionit publik, si justifikim rusët do të theksojnë se kjo rezolutë do të shërbejë si impuls për dialog të drejtëpërdrejtë midis Beogradit dhe politikanëve të moderuar të Kosovës (Vukaj, 2007:185).

SHBA-të e kishin dërguar R.Holbrukun në Beograd, për të siguruar marrëveshje me Millosheviqin. Ai zbatonte diplomacinë ecejake, dhe mendohej se do të ketë sukses për shkak të rolit të tij kyç në Marrëveshjen e Daytonit. Por Millosheviqi i cili njohu vetëm gjuhën e armëve e kishte detyruar Holbrook të kërkonte kërcënimin e NATO-s, për të realizuar Marrëveshjen me 11 pika të 13 tetorit të vitit 1998. (Weller, 2009:211). Po më 13 tetor NATO-ja e kishte lajmëruar Millosheviqin se do ta sulmonte Serbinë brenda katër ditësh në qoftë se nuk respektoheshin rezolutat e Kombeve të Bashkuara. Sulmet ajrore u pezulluan kur 4.000 oficer të forcave speciale të policisë Jugosllave u tërhoqën nga Kosova. Për pak kohë dukej se gjërat u përmirësuan, por në janar të vitit 1999 serbët përsëri filluan të vrisnin njerëz të pafajshëm në Kosovë, dhe sulmet ajrore të NATO-s dukeshin të pashmangshme (Clinton, 2005:713).

Përkundër komenteve të shumta, një gjë ishte e qartë: po ushtrohej një presioni i fortë kundër Beogradit duke lënë hapur përdorimin e forcës. Koha kërkonte zëvëndësimin e fjalës me armën kur e para tanimë qe konsumuar e fyer nga Beogradi. Për këtë Toni Bler me brengë të shtetarit vizionar dhe të vendosur shtron pyetjen se, vallë a mund të qëndroj bota e jashtme duke bërë sehir kur një shtet kriminel abuzon brutalisht të drejtat themelore të atyre që ai i qeverisë? (Blair, 2005:65). Pas mbledhjes së K.S Paskal Milo, Ministër i Jashtëm i Shqipërisë, para gazetarëve në emër të qeverisë Shqiptare, mbështet frymën e Rezolutës. Kurse ministri i Jashtëm i Serbisë, Jovanoviq, shpërndau një libër të bardhë për Kosovën në të cilën Beogradi rrekej të vërtetonte karakterin ‘’terrorist’’ të UÇK-së dhe kinse gjurmët islamike në Kosovë (Milo, 2009: 94). Të kujtojmë me këtë rast kur gazetat ruse, në tetor të vitit 1998 citonin ministrin amerikan të mbrojtjes, duke thënë se ‘’Për ne është i dëshirueshëm mandati i OKB-së, por jo i domosdoshëm. Partnerët e aleancës mund të shfrytëzojnë paragrafin e mbrojtjes kolektive, fiksuar në të drejtën ndërkombëtare’’(Vukaj, 2007:175).

Millosheviqi nuk u shqetsua shumë nga vendimet e marra në Nju-Jork. Ai llogariste se nuk do të miratohej ndonjë rezolutë tjetër ku do të autorizohej përdorimi i forcës kundër Serbisë, pasi Rusia do ta bllokonte me të drejtë vote në Këshillin e Sigurimit. Këtë ministri i Jashtëm Igor Ivanov ia kishte bërë të qartë sekretares amerikane të Shtetit. Për këtë arsye SHBA-ja dhe aleatët e saj iu shmangën përpjekjeve për të paraqitur kërkesën para K.S. për miratimin e një rezolute të re. Në vend të kësaj shtetet perëndimore të K.S. aktivitetet e veta i zhvendosën në Këshillin e NATO-s, ku Rusia nuk ishte e përfaqësuar. Nga përvoja e hidhur e çgënjyese në Bosnje SHBA-ja ishte e vendosur që të vepronte ushtarakisht kundër Millosheviqit, në rast nevoje edhe pa mandatin e K.S. (Fischer, 2008:101-102).

Perëndimi gjithnjë e më shumë bindej për lojërat joserioze e dredharake të Millosheviqit. Papërgjegjshmëria e Millosheviqit, e kishte përshpejtuar Britaninë e Madhe të përgatiste Dosjen

juridike në favor të përdorimit të forcës. Vetëm kërcënimi për përdorimin e forcës, sado i ashpër, është i pamjaftueshëm, do të deklarojnë Toni Bler dhe Bill Clinton (Blair, 2005:7). Në këtë rast duhet kujtuar fjalimin e Toni Bler në Çikago (Ky fjalim do të njihet si ‘’Doktrina Bler’’) ku theksonte se, në mijëvjeçarin e ri diktatorët duhet ta dinë se ‘’Nuk mund ta shtypin popullin e vet ose të ndërmarrin spastrim etnik pa u ndëshkuar’’ Ne nuk do të luftojmë për territore por për vlera. (Blair, 2005:8).

Kryetari amerikan Bill Clinton, kishte udhëzuar delegacionin e vet në NATO që të votonte për autorizimin e sulmeve ushtarake kundër Serbisë, nëse Millosheviqi vazhdon ta sfidojë bashkësinë ndërkombëtare. Sekretarja e shtetit Olbrajt përsëriste e vendosur se Aleanca e kishte legjitimitetin për të vepruar dhe për të ndalur katastrofën, se aksioni humanitar është i pranueshëm politikisht dhe juridikisht edhe pa mandatin e Këshillit të Sigurimit (Weller, 2009:178).

KAPITULLI II:

FITORIJA E KOSOVËS NË RAMBUJE

Kosova të flas me një zë të vetëm

E bëmë këtë hyrje pasi ajo ka harmoni logjike me ngjarjen kulmore të Rambujesë historike, se ngjarjet brënda kësaj kohe paraprake qenë ushqyeset prej nga kulmoi dhe Rambujeja me dafinën e lirisë së Kosovës brënda saj. Pa të parat, pa qëndresën e gjatë të popullit të Kosovës e pa armët e të lavdishmes UÇK nuk vinte e dyta. Rambujeja është pika e ëndërruar ku armët e Kosovës u harmonizuan me diplomacinë euro-atlantike. Ajo qe limani i sigurt pas një lundrimi të gjatë nëpër dallgë të egra i popullit kosovar.

Lufta heroike e UÇK-së bëri që bota t’i kthejë plotësisht sytë nga Kosova me tërë seriozitetin e saj. Lëvizja çlirimtare është faktori themelor i ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, i imponimit të saj si çështje politike e gjeopolitike (Akademia e Shkenave, 1999:138). Kur flasin armët, diplomacia ulet i bën më saktë llogaritë. UÇK-ja ishte fermenti që çoi në zgjidhjen radikale të problemit të Kosovës. Pa UÇK-në Kosova do të vazhdonte ende të vërtitej në vorbullën e diplomacisë boshe, të një diplomacie joefektive, që do të kënaqej me deklarata dhe jo me veprime konkrete diplomatike që synon zgjidhjen reale afatgjate të çështjes së Kosovës (Milo, 2009:116).

Konferenca në Rambuje “duhet parë si ngjarja më e rëndësishme ndërkombëtare, e mbajtur ndonjëherë për Kosovën dhe ndoshta për kombin tonë në përgjithësi” thotë në librin e tij Jakup Krasniqi (Krasniqi, 2006:158). Konferenca e Rambujesë krijoi bazë legale për njohjen ndërkombëtare të së drejtës për vetëvendosje të popullit të Kosovës, duke shënuar hap përpara drejt pavarësisë (Tahiri, 2001:10). Apo siç do të shprehet Rexhep Qosja: “...Kjo është ngjarje më vendimtare në historinë e Kosovës prej Konferencës së Ambasadorëve në Londër 1912-1913. Në të vërtetë në Konferencën e Rambujesë po bëhej ndryshimi më i vogël a më i madh, i përfundimeve të Konferencës së Londrës ku u përcaktua ardhmëria e rëndë dhe tragjike e një pjese të shqiptarëve...” (Qosja, 1999:16).

Me qëllim të ndërprerjes së luftës, dhe për të vazhduar zgjedhje diplomatike, Bashkësia Ndërkombëtare e në veçanti SHBA’të bënë përpjekje maksimale për ta kompozuar delegacionin

negociator të Kosovës. Thirrja e bashkësisë ndërkombëtare që ''Kosova të flasë me një zë të vetëm'', kishte në thelb përfaqësimin e krahut luftarak, në të gjitha tryezat e bisedimeve (Akademia e Shkencave, 1999:136).

LDK-ja e Ibrahim Rugovës, e cila pretendonte ''legjitimitetin qeverisës'' pasi dy here kishte fituar në zgjedhje me shumicë absolute, pengonte formimin e delegacionit negociator me bazë të gjerë. LDK-ja kishte filluar të braktisej nga përkrahësit e saj për shkak të zhgënjimit nga mossuksesi i fushatës së tij të mosdhunës. Kështu vetëm në gjysmën e vitit 1998 kur grupi jozyrtar i udhëhequr nga Fehmi Agani iu përgjigj projekteve të njëpasnjëshme të Christ Hillit, u mundësua që të krijohej një ekip negociatorësh me bazë më të gjerë, të përfshirjes edhe të UÇK-së (Weller, 2009:217).

Parimet e grupit të Kontaktit dhe thirrja e Adem Demaçit për refuzimin e tyre

Historia na mëson se Evropa nuk ka qenë e zonja që në hapsirën e vet të zgjidhë çështjet e ngatërruara mes kombesh, të cilat ajo vetë i ka bërë lëmsh për interesa të saj. Këtë e dëshmon edhe dështimi në Konferencën për Bosnjën. Angazhimi transatlantik i Amerikës e ka shpëtuar Europën nga dy luftëra gjatë këtij shekulli (Blair, 2005:84). Grupi i Kontaktit përbërë nga; SHBA-ja, Britania e Madhe, Italia, Franca, Gjermania dhe Rusia, fillimisht ishte themeluar në pranverën e vitit 1994, për të ndihmuar trajtimin e çështjes së Bosnjës. Evropa për të dëshmuar se ishte në gjendje të merrte kryesimin në zgjidhjen e qështjeve të saj të brendshme, dëshironte që Konferenca e Rambujesë të zhvillohej në Evropë e jo në SHBA (Fischer, 2008:128).

Grupi i Kontaktit, interesimin intensiv për Kosovën e filloi në shtator të vitit 1997 me shfaqjet e hapura të armiqësive. Grupi kishte kombinuar tre elemente: Rusia, që shihej si shtet që mund ''të merrej me Millosheviqin'', duke marrë parasysh përkrahjen e saj të përhershme për pozicionin e Serbisë. Kurse anëtarët e BE-së, do të mund t'ia tregonin Beogradit karotën e integrimit më të afërt ekonomik me Evropën. Përderisa SHBA-ja, paraqitej si forcë udhëheqëse e një aksioni më të ashpër, duke përfshirë këtu edhe përdorimin e forcës ushtarake (Weller, 2009:151).

Në deklaratën e 24 shtatorit 1997, Grupi i Kontaktit thotë: ''Në lidhje me kontekstin për statusin e Kosovës, pozicioni i Grupit të Kontaktit është shumë i qartë: ne nuk e përkrahim Pavarësinë dhe nuk e përkrahim mbajtjen e status quo-së. E përkrahim një status të avancuar të Kosovës brenda RFJ-së. Ky status do të duhej t'i mbronte plotësisht të drejtat e popullatës shqiptare në pajtim me standardet e OSBE-së dhe Kartën e OKB-së. Është esenciale që dialogu të nisë, si hap i parë për t'i ulur tensionet'' (Weller, 2009:151).

Në rastin e Kosovës, Grupi formuloi një kornizë për Negociata në Rambuje, për një zgjidhje kalimtare bazuar në dhjetë parimet e panegociueshme të definuara nga Grupi i Kontaktit në takimin e 29 janarit 1999. Për ndërtimin e këtyre parimeve Grupi i Kontaktit mori parasysh edhe qëndrimet e palëve negociatorë, natyrisht deri në një masë për të mos u tejkaluar korniza e definuar ndërkombëtare (Tahiri, 2002:55).

Pranimi i dokumentit të dhjetë parimeve të panegociueshme nga palët negociatore ishte

parakusht për pjesëmarrje në Konferencën e Rambujesë. Ato ishin:

1. *Domosdoshmëria e ndërprerjes së menjëhershme të dhunës dhe respektimi i armëpushimit.*
2. *Zgjidhja paqësore përmes dialogut.*
3. *Marrëveshja kalimtare: një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare pas periudhës kalimtare trevjeçare.*
4. *Mosndryshimi unilateral i statusit kalimtar.*
5. *Integriteti territorial i RSFJ-së dhe i vendeve fqinje.*
6. *Mbrojtja e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive nacionale (ruajtja e identitetit, gjuhës dhe arsimit: mbrojtja e veçantë e institucioneve të tyre religjioze).*
7. *Zgjedhje të lira dhe të ndershme në Kosovë nën mbikëqyrjen e OSBE-së.*
8. *Asnjë palë nuk do të ndjekë penalisht dikë për krime që lidhen me konfliktin e Kosovës (përveç: krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës, dhe shkeljeve të tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare).*
9. *Amnistia dhe lirimi i të burgosurve politikë.*
10. *Pjesëmarrja ndërkombëtare dhe bashkëpunimi i plotë i të gjitha palëve në implementim.*

(Tahiri, 2002:56).

Por jo të gjitha këto pika ishin të pranueshme për shqiptarët. Adem Demaçi i pari u deklarua për mospjesëmarrje të shqiptarëve në negociatat për statusin e Kosovës në Rambuje. Pika e pestë e projektmarrëveshjes ishte pika më kontestuese për gjithë shqiptarët, por Adem Demaçi nuk donte të kalonte as një hap përpara pa u ndryshuar kjo pikë. Deklarimi i tij ishte se: “Të shkosh në Rambuje dhe të pranosh paraprakisht këto dhjetë pikat e panegociueshme, ku njëra prej tyre garanton sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë, do të thotë të heqësh dorë nga pavarësia dhe të lëshohesh në autonomi”. Më 2 shkurt, Adem Demaçi në takimet e tij të zakonta me media, publikisht deklaron se “Shqiptarët nuk duhet të shkojnë në Rambuje”. E ftoi Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së të refuzonte ftesën e bërë nga Grupi i Kontaktit për të marrë pjesë në Konferencën për Kosovën, sipas të cilit Kosovës po i ofroheshin pranga të reja (Shala, 2001:218).

Adem Demaçi, i shquar me origjinalitetin e qëndrimeve të tij dhe aspak diplomatik, në konferencën për shtyp madje kërkoi që Depertamenti i Shtetit të zëvendësojë negociatorët amerikan Holbrook dhe Hill si të papërshtatshëm, që nuk njohin qështjen shqiptare dhe që anojnë nga pala serbe ose u përshtaten kërkesave të saj (Milo, 2009:114). Por Demaçi si i tillë, kokëfortë e “i pamarrëvesh” sic do të thoshte populli, dhe me refuzimet e tij të njëpasnjëshme, ndikonte që Uashingtoni në radhë të parë, por edhe qeveritë e tjera Perendimore, të kuptonin se Kosovarëve duhet t’u ofrohet një Marrëveshje e ndershme Kalimtare. Pra edhe një Demaç si ky, i duhej Kosovës (Shala, 2001:298).

Platforma politike e shtabit të përgjithshëm të UÇK-së

Çështjen e shkuarjes ose të mos shkuarjes në Rambuje, e sidomos pas deklarimeve të hapura të Adem Demaçit, SHP i UÇK-së e ka shqyrtuar me seriozitetin më të madh, duke e analizuar në mënyrë të gjithanshme. UÇK e dinte se atje nuk shkonte për pavarësinë e Kosovës, se deri te pavarësia duhej edhe shumë punë për t'u bërë. Fundja ishte UÇK që i kishte hapur portat për delegacionin shqiptar. (Krasniqi, 2006:158). Por duke parë se lufta kishte hyrë në një fazë të re, të përmasave të gjera operative, duke parë sabotimin që po i bënte luftës "Qeveria e Bukoshi" si dhe mbyllja e rrugëve furnizuese, UÇK-ja pranoi për të shkuar në Rambuje për të nxjerr një pushim trevjeçarë. Bukoshi nuk jepte mjete për financimin e UÇK-së, kurse në anën tjetër duke i shfrytëzuar ato mjete, u shpërndante aty këtu individëve të caktuar, si duket vetëm për të futur përçarje. (Krasniqi, 2006:159). Edhe shpresa e vetme e Kosovës për të arritur diçka në fushën politike, ishte nëpërmjet përfshirjes së fuqishme ndërkombëtare. Humbja e elementit të ''ndërkombëtarizimit'' të krizës do të ishte një katastrofë më e madhe sesa çfarëdo humbje ushtarake (Weller, 2009:211).

Shtabi i Përgjithshëm formuloi edhe platformën politike që delegacioni i UÇK-së do ta mbronte në Rambuje. Gjatë bisedimeve në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë, siç dihet i tërë delegacioni i Kosovës ishte i përkushtuar të mbronte Platformën politike të SHP të UÇK-së. Bashkimi i delegacionit të Kosovës rreth një platforme politike ishte suksesi më i madh i arritur. Delegacioni i UÇK-së kishte marrë qëndrimin se në Rambuje duhet të mbrohen këto pika:

- *Të ruajë bashkëpunimin në kontinuitet me bashkësinë ndërkombëtare, duke mos lejuar humbjen e përkrahjes dhe ndihmës ndërkombëtare.*
- *Nëse Serbia nuk do të shkonte në Rambuje, ose nuk do të nënshkruante, UÇK-së do t'i jepej një përkrahje më e madhe dhe më e gjithanshme në aspektin ushtarak (të armatimit) dhe*
- *Nëse do të nënshkruhet nga dy palët Dokumenti përfundimtar i Konferencës, UÇK-ja do të arrinte një armëpushim trevjeçar për të cilin kishte nevojë* (Krasnici, 2006:160).

Këto ishin arsyet themelore të shkuarjes në Rambuje të delegacionit të UÇK-së, ku tanimë udha e diplomacisë qe shtruar sipër udhës së armëve. Me vete qenë edhe kërkesat e tij maksimale që delegacioni do t'i shtronte në Konferencë. Ato përmblidheshin në shtatë pika:

1. *Largimi i pa kusht i të gjitha forcave të armikut nga Kosova.*
2. *Lirimi i të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë.*
3. *T'i njihet e drejta e popullit të Kosovës për të vetëvendosur pas tri viteve me referendum për statusin përfundimtar.*
4. *E drejta e Kosovës për të pasur forcën e saj mbrojtëse.*
5. *Sigurimin dhe mbrojtjen e Kosovës ta bënte NATO nën mbikëqyrjen e SHBA-ve.*
6. *Në mbrojtjen e kufijve të Kosovës, së bashku me trupat e NATO-s të merrnin pjesë edhe*

ushtarët e UÇK-së, dhe

7. *Armatimi i rëndë serb të mbetej në Kosovë, si kundërvlerë për dëmet e luftës* (Krasniqi, 2006: 161).

Ishte e qartë që këto ishin kërkesat maksimale që duhej të mbroheshin, por në raste reduktimi, më i mundshmi që duhej të jetë i pranueshëm për UÇK-në mund të ishte:

- *Ardhja e NATO-s për të siguruar paqen trevjeçare dhe largimi i forcave armike.*
- *Organizimi i Referendumit gjithëpopullor në Kosovë pas tri vjetësh për përcaktimin e statutit përfundimtar.*
- *Transformimi i UÇK-së në Forcë Mbrojtëse të Kosovës, dhe*
- *Lirimi i të burgosurve politikë shqiptarë* (Krasniqi, 2006:161).

Pas debateve të shumta të zhvilluar në nivel të Shtabit të Përgjithshëm, të Drejtorisë Politike dhe të komandantëve të zonave, si dhe marrjes së pëlqimit të tyre është dhënë drita e gjelbër për shkuarje të delegacionit të UÇK-së në Rambuje. Fitorja e parë (sado ende e ngushtuar) që dilte nga kjo pjesëmarrje në këtë Konferencë ishte pranimi dhe legjitimimi ndërkombëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftës së saj të drejtë. Kosova po legjitimohej tanimë jo si problem i brendshëm i Serbisë dhe Jugosllavisë, por si problem i përmasave ndërkombëtare. Është fakt se Kosova, asnjëherë në historinë e saj nuk kishte qenë në fokus të vëmendjes së faktorit ndërkombëtar siç gjendej tani. Hapsira kohore që krijohej prej tre vjetësh, synohej të shfrytëzohej për konsolidim të brendshëm në të gjitha stadet, në atë ushtarak, politik e strategjik (Buja, 2007: 322).

Mbrojtësit e kështjellave në Kështjellë

Më 5 shkurt delegacioni shqiptar ishte mbledhur dhe kishte arritur një marrëveshje parimore për tri pikat kryesore: e para, cilido që të ishte numri i anëtarëve të tij, do të ruhej ekuilibri në përfaqësimin e UÇK-së, LDK-së, LBD-së; e dyta, vendimet do të merreshin me konsensus të plotë, pa pëlqimin e njërit prej këtyre tre elementeve kryesorë të delegacionit nuk do të kishte asnjë vendimmarrje; si dhe përcaktimi i shefit të grupit negociator (Milo, 2009:142). Delegacioni përbëhej prej 16 anëtarëve (Petritsch, 2002:176).

Në përbërje të delegacionit ishin: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Ram Buja dhe Xhavit Haliti, përfaqësonin UÇK'në. Bënte pjesë edhe grupi nga LBD-ja (Lëvizja e Bashkuar Demokratike) me:

Mehmet Hajrizin, Rexhep Qosjen, Hydajet Hysenin dhe Bajram Kosumin. Kurse LDK-ja në delegacion kishte përcaktuar: Fehmi Aganin, Ibrahim Rugovën, Idriz Ajetin Edita Tahirin dhe Bujar Bukoshin. Në delegacion bënin pjesë edhe dy përfaqësues të pavarur: Blerim Shala dhe Veton Suroi. Me delegacionin shqiptar ishin edhe ekspertët: Arsim Bajrami, për çështje kushtetuese, Enver Hasani për të drejtën ndërkombëtare, Musa Limani për ekonomi, Sabaudin Komoni për financa, Avni Jarshellari dhe Sokol Bare për çështjet e sigurisë, Naip Zeka për resurset natyrore, Shenasi Rama dhe Xhavit Rexhaj për çështje ndërkombëtare, Agim Çeku dhe Adem Qopani për çështje ushtarake. Delegacioni për këshillime kishte edhe ekspertë të shquar ndërkombëtarë si: Mark Weller, ekspert i shquar i së drejtës ndërkombëtare dhe Norton Ambramoviç, jurist i shkëlqyeshëm. Shqiptarët gjatë Konferencës komunikuan edhe me ekspertë të tjerë të fushave të ndryshme.

Beogradi për Hashim Thaçin shpalli (një komedi sipër tragjedisë së Kosovës), arrestin ndërkombëtar, kurse për ta penguar pjesëmarrjen e delegacionit shqiptar në Rambuje, përfaqësuesit e UÇK-së i shpalli ‘’teroristë e banditë’’ Disa në mungesë i denoi edhe me vdekje (Akademia e Shkencave, 1999:143).

Për shkak të pengesave serbe, delegacioni i UÇK-së më 5 shkurt nuk arriti në Rambuje ashtu siç ishte planifikuar. Udhëtimi u realizua më 6 shkurt, me 2 aeroplanë të vegjël të Qeverisë Franceze. Shqiptarët të njohur në histori si mbrojtës të kështjellave, (shprehje e Jakup Krasniqit) të përcjellur nga populli, tani po udhëtonin drejtë Kështjellës, ku do të mbyllen për 23 ditë, për ti sjellë paqe Kosovës (Krasniqi, 2006:166). Gjithësesi sa të ngushta e komode janë kështjellat luksoze të Europës për të mbajtur brënda kështjellat madhështore e dramatike të shqiptarëve, ngarkuar tani në supet e delegacionit shqiptar! Por ata i mbingarkuan, pasi supet u qenë forcuar më tej nga armët që tanimë i kishin marrë përsipër në rast dështimi. Kjo tani kish dhe dëshminë më të afërt me vete. Në hyrje delegacioni i UÇK-së u desh të dorëzojë armët e marra për vetëmbrojtje gjatë rrugës deri në aeroportin e Sllatinës në Prishtinë, ku mendohej se nëse serbët do të provonin t’i zinin robër, ata nuk do të dorëzoheshin të gjallë (Shala, 2001:222).

Delegacioni serb në negociatat për Kosovën në Rambuje

Beogradi nën trysninë e kërcënimeve të NATO-s, pranoi më në fund të merrte pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje edhe pse, deri atëhere çështjen e Kosovës e quante ende çështje të brendshme të saj. Delegacioni serb që u caktua për Konferencën kryesohej nga Ratko Markovic, nënkryetar i qeverisë së Serbisë; më pas kryesimin e delegacionit e mori përsipër kryetari i Serbisë, Millan Millutinoviq (Fischer, 2008: 133). Përbëhej nga 13 veta, shumica nga Kosova, përfaqësues të minoriteteve të qena e të paqena, përfshirë edhe dy kryetarë shqiptarë të partive të shpikura (Milo, 2009:142). Ky ishte synim i dëshpëruar për të dëshmuar ‘’tolerancën multietnike’’ të Serbisë. Përveç dy shqiptarëve të ‘’ndershëm’’ (term i shpikur në vitet e ’80) aty kishte futur edhe një boshnjak, një goran, dy turq, një rom, madje edhe një ‘’egjiptas’’ zbulim ky i ri i regjimit serb (Shala, 2001:221).

Rambujeja ofronte shancin më të mirë të mundshëm të një paqeje afatgjate në rajon, por RFJ-ja nuk tregoi as qëllimin më të vogël të angazhimit në negociata serioze (Gecaj, 2009:55). Në fakt Beogradi shumë pak ishte i interesuar për të arritur një zgjidhje, pasi përfshirja ndërkombëtare pashmangshëm do të prishte status quo-në e favorshme për të. Prandaj dhe sipas skenarit serb

konferenca duhej të dështonte, kurse faji do t'i ngarkohej delegacionit të Kosovës, dhe në këtë mënyrë Serbisë do t'i lejohej kontrolli në at territor (Weller, 2009:216). Duke patur parasysh këto rrethana të mundëshme e të pamundëshme, Millosheviqi nuk mori pjesë në Rambuje, por dërgoi një delegacion, sa qesharak dhe nënçmues, si për shqiptarët dhe për Bashkësinë Ndërkombëtare. U bënë të njohur si ''klubi i çajit'' ngase shiheshin duke pushuar nëpër hapësira publike të Kështjellës, duke u freskuar gjatë gjithë ditës, e duke kënduar këngë patriotike serbe deri në orët e vona të natës (Weller, 2009:219).

Delegacioni serb kishte qëndruar i heshtur deri atëhere kur ambasadori Hill udhëtoi për në Beograd për bisedime të drejtpërdrejta me Millosheviqin, edhe pse nuk e kishte autorizuar Grupi i Kontaktit. Ky udhëtim i K.Hillit me bashkëpunëtoët e tij, pa njohtuar përfaqësuesin Rus dhe ate të BE-së si dhe as drejtorin politik francez dhe ate britank, qartësonte synimin që përfaqësuesit e B.E-së, e me këtë rast edhe BE-ja vetë të lihej anash. Ky udhëtim edhe mund të kishte pasoja negative, ngase pala serbe, vetëm priste plasaritje dhe prirje për përçarje në radhët e taborit perëndimor, gjykonte Ministri i Jashtëm gjerman Joschk Fischer në librin e tij (Fischer, 2008:138). Duket se gjatë atyre bisedimeve, Jugosllavia i kishte identifikuar kërkesat kyçe që duhej të plotësoheshin nëse pritej që delegacioni serb t'i qasej Konferencës me seriozitet (Weller, 2009:221). Megjithate Serbisë i ishte thënë troç, se nëse Konferenca dështonte për shkak të mosbashkëpunimit të tyre, ata do të bombardoheshin (Gecaj, 2009:51).

Takimet e para

Konferenca u hap në Kështjellën e vjeter të Rambujesë me fjalimin e kryetarit francez, Zhak Shirak, më 6 shkurt 1999. Fjalimi i tij përveç theksit për rëndësinë e Konferencës kishte edhe porosinë e përgjithshme: "..nuk do të tolerojmë vazhdimin e këtij konflikti që shkel parimet thelbësore të dinjitetit njerëzor. Ne nuk duhet të tolerojmë që dhuna të kërcënojë stabilitetin e gjithë Evropës Juglindore, ne duam paqe për kontinentin tonë.." do të shprehet kryetari i Francës në hapje të Konferencës për Kosovën në Rambuje (Shala, 2001:222).

Pas fjalimeve të shefave të diplomacive britanike dhe franceze, Robin Kuk dhe Hubert Vedrine, të dy palëve iu dha projekti fillestar, që e përmbante Marrëveshjen korrnizë, aneksin kushtetues si dhe anekset për zgjedhjet dhe Ombuspersonin e propozuar. Delegacioni shqiptar do të mbante nga ana e tij edhe mbledhjen e pare për akordimin e delegacionit. Fjalën e parë e merr Rexhep Qosja me fjalorin e tij prej rilindësi, duke përshëndetur, "djemtë trima pjesëtar të UÇK-së", dhe duke shprehur gëzimin e të qenit bashkë me ta në këtë Konferencë tepër të rëndësishme për Kosovën. Ndër të tjera ai thotë. "Ne shikonim për tokë e ata na kthyen nderin dhe dinjitetin. Ne ishim objekt në politikë e ata me flijimin e tyre, me luftën e tyre na bënë subjekt. Bota sot po merret

me Kosovën. Këta djem bënë që sot Kosova të bëhet çështje e parë botërore". Për t'u bërë një nder i madh pjesëtarëve të UÇK-së dhe për të paraqitur unitetin e plotë para faktorit ndërkombëtar, si udhëheqës të delegacionit në Konferencë e propozoj Hashim Thaçin". Por për shkak të mos pranisë së tij vendimi nuk u morr menjëherë (Shala, 2001:224).

Koha po provonte se pa UÇK-në në Rambuje, nuk do të lëvizte asgjë. Kurse Hashim Thaqi si zëdhënës i tyre në rrjedhën e Konferencës, u shëndrrua në figurë vendimtare në radhët e delegacionit të shqiptarëve të Kosovës (Fischer, 2008:133). Ndërmjetësit ndërkombëtar tanimë e kishin të qartë se pa pjesëmarrjen e UÇK-së nuk mund të gjendej asnjë zgjidhje për çështjen e Kosovës (Petritsch, 2002:172). Më vonë delegacioni zgjodhi kryesinë e delegacionit me: Hashim Thaçin, Rexhep Qosjen dhe Ibrahim Rugovën. Udhëheqës të delegacionit për negociata në këtë Konferencë kryesia zgjodhi Hashim Thaçin, Kryeshef i Drejtorisë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Organizuesit e konfeencës do ta presin në heshtje këtë vendim (Qosja, 1999:47).

U caktuan edhe detyra tjera në kuadrin e delegacionit në përputhje me detyrimet që shtronte puna dhe angazhimi në Konferencë. Përzgjedhja e njerëzve për grupet e punës u bë duke pasur parasysh aftësinë dhe emrin e secilit, për kryerjen sa më të mirë të punës dhe detyrës së caktuar. Sektorët në të cilët u profilizua delegacioni ishin:

Sektori politik, ku bënin pjesë: *Jakup Krasniqi, Mehmet Hajrizi, Fehmi Agani dhe Blerim Shala*.

Në sektorin për mbrojtje e siguri: *Azem Syla, Edita Tahiri, Xhavit Haliti, Jakup Krasniqi e Hydajet Hyseni,*

Në sektorin për ekonomi: *Mehmet Hajrizi, Ramë Buja, Bujar Bukoshi, Bajram Kosumi,*

Grupi për hartimin e platformës së përbashkët: *Rexhep Qosja, Edita Tahiri, Veton Surroi, Bujar Bukoshi, Idriz Ajeti.*

Në grupin për informim*; Ramë Buja, Dukagjin Gorani, Adnan Merovci, Skënder Hyseni* (Buja, 2007: 339). Që të gjitha këto grupe punuan me përkushtimin më të lartë, për të arritur maksimumin e mundshëm, në rrugën drejt pavarësimit të Kosovës (Buja, 2007: 339).

Fillimet e punës në Kështjellë

Delegacioneve nuk do t'u lejohet dalja jashtë mureve të kështjellës, për këtë dhe gazetat franceze delgacionet i cilësuan si ''të burgosurit e Kështjellës'' dhe se atyre u është imponuar ''regjimi i portave të mbyllura'' (Milo, 2009:145). Takimet e punës delegacioni shqiptar i fillonte në orën 9 të mëngjesit (Qosja, 1999:75). Takimi i parë është realizua me ndërmjetësit ndërkombëtarë: Ambasadorin e SHBA Kristofer Hill, të Federatës Ruse, Boris Majorski si dhe të BE-së austriakun Volfgang Petrich. Delegacioni serb nuk kishte pranuar të merrte pjesë në ceremoninë e hapjes në të njëjtën sallë me shqiptarët (Petritsch, 2002:172). Në këtë takim kryesuesi i delegacionit Hashim Thaçi kërkoi nga ndërmjetësit ndërkombëtarë nënshkrimin e një marrëveshje për armëpushim, derisa Konferenca të mbarojë punimet (Shala, 2001:235). Negociatori rus Majorski e akuzoi delegacionin se me këtë kërkesë përpiqet të kushtëzojë negociatat (Milo, 2009:146).

Kërkesa për armëpushim kishte për qëllim që pjesëmarrësve të konferencës t'u sigurohej një qetësi elementare për punën me aq përgjegjësi që duhej bërë. Kërkesës iu bashkëngjit edhe mocioni për nënshkrim, por ky nënshkrim nuk u realizua sepse nuk e pranoi pala serbe, edhe pse kërkesa nuk u kundërshtua nga ndërkombëtarët (Buja, 2007:339). Synimet e perëndimit në këtë Konferencë ishin më se të qarta: Ndaljen e luftës në Kosovë, stacionimin e Paktit NATO në territorin e Kosovës dhe inicimin e proceseve të vetëqeverisjes i cili duhej të "mbulonte" fazën kalimtare në Kosovë. Përfundimi me sukses i Konferencës ishte synim i palëkundur i Uashingtonit. Ardhja e shpeshtë e diplomatëve perëndimor në kështjellë si Robin Kuk, Iber Vedrin, Lamberto Dini, Joshka Fisher, pastaj, qëndrimi aq i gjatë i Sekretares së shtetit të SHBA-ve Znj. Medelin Olbrajt mes delegacioneve kah fundi i konferencës, veçanërisht me delegacionin shqiptar, tregonte përkushtimin e madh të shtetarëve të vendeve më të fuqishme të botës për Konferencën. Çështja e statusit final të Kosovës nuk duhej të hapej në Konferencën e Rambujesë, ngase të gjithë pjesëmarrësit e kishin të qartë, se madje edhe në rast se do të arrihej pajtimi, çështja e statusit përfundimtar nuk do të mund të zgjidhej këtu menjëherë (Fischer, 2008:133).

Delegacioni shqiptar me konsensus formuloi synimet strategjike të Kosovës bashkë me kompromiset e së mundshmes, për ato që duheshin arritur në Konferencë. Të gjithë ishin në një zë, të pranojnë marrëveshjen kalimtare për Kosovën por që kjo marrëveshje duhet të përfshijë edhe mekanizmin e shprehjes së vullnetit të popullit të Kosovës për vetëvendosje pas tre vjetëve. Marrëveshja duhet të mbikëqyret nga ndërkombëtarët respektivisht NATO. Pastaj, nuk mund të arrihet kompromis për çarmatosjen e UÇK-së. Statusi kalimtar nuk duhet të paragjykojë statusin final të Kosovës. Delegacioni me vendosmëri duhet të këmbëngulte në tërheqjen e plotë të trupave serbe nga Kosova.

Kjo ishte baza e platformës për negociata, për të arritur një zgjidhje të pranueshme dhe të përkohëshme për Kosovën. Teksti i Platformës kishte këtë përmbajtje:

- Tërheqja e të gjitha forcave të armatosura të Serbisë prej Kosovës;

- Mospranimi i Integritetit territorial të Jugosllavisë së mbetur;

- Vendosja e trupave tokësore të NATO-s në Kosovë;

- Krijimi i aftësisë së kufizuar mbrojtëse përmes transformimit të UÇK-së në Bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare;

- Pranimi i kushtetutës kalimtare për afat tre vjeqar, që bën të mundshëm themelimin e një qeverie demokratike;

- Njohja e referendumit për statusin përfundimtar të Kosovës, pas skadimit të Marrveshjes kalimtare;

- Krijimi i kushteve për promovimin e ekonomisë së tregut në Kosovë, dhe për themelimin e bankës Qendrore të Kosovës;

- Njohja e pandryshueshmërisë së kufijve ekzistues të Kosovë;

- Njohja e Kosovës si etnitet i përcaktuar territorial, politik dhe juridik;

- Bashkëpunimi me Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi;

- Mbajtja e Jugosllavisë së mbetur nën sanksionet ndërkombëtare përderisa jugosllavia e mbetur nuk pranon obligimet për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës;

- Pjesëmarrja e Kosovë në procesin e suksesionit në lidhje me ish Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë;

- Krijimi i llogarisë për reparacione dhe rikonstruim, në të cilën Jugosllavia e mbetur do të derdhte mjetet në shumë të dëmshpërblimit të caktuar ndërkombëtarisht;

- Identifikimi i Marrëveshjes Kalimtare si traktat ndërkombëtar, i regjistruar në OKB;

- Përfshirja e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s dhe kryesuesit të OESB-së si garantues të korrnizës së Marrveshjes (Qosja, 1999:93).

Serioziteti i bisedimeve kërkonte domosdoshmërinë e ekzistimit të platformës politike të përbashkët (Krasniqi, 2006:168). Vendosmëria dhe këmbëngulja e delegacionit për të realizuar objektivat e platformës politike nuk kanë munguar. Për çdo çështje, është diskutuar hapur mes delegacionit, jo vetëm në mbledhjet plenare por edhe në takimet spontane. Por të ndodhur nën trysninë e raportit të forcave kombëtare e ndërkombëtare, u bë që platforma të pësojë ndryshime. Fatmirësisht, veprimi racional dhe i guximshëm i delegacionit shqiptar, si dhe ai irracional dhe i pa arsyeshëm i delegacionit serb, solli përmbushjen favorizuese të platformës, marrëveshjes si dhe Konferencës në tërësi për fatin e shqiptarëve dhe të Kosovës (Buja, 2007:348).

Marrëveshja

Dokumenti më i rëndësishëm ishte "Marrëveshja" që duhej nënshkruar nga të dy palët negociatore dhe ndërmjetësuesit. Njihej me emrin **''Interim Agrement for Peace and Self-Government in Kosova"** (shqip) - "**Marrëveshja e ndërmjetme (përkohshme, kalimtare) për paqe dhe vetëqeverisjen në Kosovë**" (Akademia e Shkencave, 1999:144).

Marrëveshja ishte një sistem më i mirë e më diplomatik se sa idetë paraprake të paraqitura. Përveç parimeve të përgjithëshme Marrëveshja trajton edhe çështjen e sigurisë dhe institucionet vetqeverisëse në Kosovë, të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Kurse garant për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë forcat ndërkombëtare që do të vendosen në Kosovë. Sa i përket çështjes së përcaktimit të statusit të Kosovës është evituar në mënyrë shumë të hollë e të paqartë, për të mos hedhur që në fillim në erë tërë Marrëveshjen (Milo, 2009:144).

Grupi i Kontaktit kishte vendosur që pjesa e parë e bisedimeve t'i kushtohet vetëm pjesës politike të marrëveshjes e cila ishte komplekse, por edhe vendimtare në vështrimin afatgjatë. Vetëm kur të arrihej marrëveshja për këtë pjesë do të diskutohej edhe për çështjet e sigurisë. Mund të debatohej apo edhe të propozohej natyrisht, por jo edhe të ndryshohej diqka ''Ëmbëlsira hahet në fund'' kishte thënë Hilli (Milo, 2009:148).

Në kapitullin e parë të Marrëveshjes me titullin "Ndërtimi institucional", janë të përfshira principet bazë të vetëqeverisjes së Kosovës me principet e demokracisë (neni një), Parlamenti dhe presidenti (neni dy dhe tre), Qeveria dhe organet administrative (neni katër), Sistemi Juridik (neni pesë), Liritë dhe të drejtat themelore njerëzore (neni gjashtë), Bashkësitë kombëtare (neni shtatë), Sistemi komunal (neni tetë), Sistemi i përfaqësimit (neni nëntë), Një amendament i shtuar gjatë debateve dhe dispozita e hyrjes në fuqi (neni dhjetë) (Buja, 1997:351).

Në kapitullin e dytë, përcakton rolin e policisë dhe sigurisë publike qytetare. Parimet e përgjithshme (neni një), Policia komunale (neni dy), roli dhe vendi i Akademisë Policore (neni tre), Kompetencat e komisionit të drejtësisë (neni katër), Rruga ligjore e operacioneve policore në Kosovë (neni pesë), Angazhimi i palëve për sigurinë në kufijtë ndërkombëtar (neni gjashtë).

Në kapitullin tre përfshihen, kushtet e zgjedhjeve (neni një), Roli i OSBE-së në procesin zgjedhor (neni dy), Të drejtat e Komisionit Qendror Zgjedhor (neni tre).

Në kapitullin e katërt, trajtohen çështjet ekonomike. Në një kaptinë të veçantë përshkruhen angazhimet ndërkombëtare dhe të palëve në marrëveshje për asistencë humanitare, rindërtim dhe zhvillim ekonomik (Buja, 2007: 351).

Në kapitullin pestë, përfshihet implementimi, institucionet politike dhe raportet në mes tyre (neni një), përgjegjësitë dhe pushtetet (neni dy), Statusi i misionit (neni tre), Procesi i zbatimit (neni katër).

Në kapitullin e gjashtë, gjerësisht flitet për Ombudsmanin.

Në kapitullin e shtatë, i cilësuar si implementimi II, Detyrimet e palëve dhe të intermediatorëve (neni një), Rruga e çmilitarizimit dhe afatet (neni ndy), Vendi i forcave ushtarake Jugosllave dhe të "forcave të tjera" (neni tre), në fund flitet për autoritetin dhe operacionet e një force ndërkombëtare që do të mbajë shkurtesën KFOR. Këtu flitet edhe për kontrollin e kufirit dhe hapësirës ajrore, si dhe roli e funksioni i komisionit të përbashkët ushtarak dhe përgjegjësia e forcave shumëkombëshe për garantimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Në kapitullin tetë, hyjnë dispozitat e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe të modaliteteve të mundëshme për ndryshim a përmirësim (Buja, 2007:352).

Delegacioni shqiptar i Kosovës ishte i angazhuar tejmase për të studiuar dokumentet në çdo imtësi. Si rrallëherë, ai dëshmonte aktivitet konstruktiv duke parashtruar komente të detajuara dhe përmbajtësore ndaj propozimeve që ua kishte dhënë Grupi i Kontaktit. Komentet pastaj i nënshtroheshin një debati shumë serioz në mbledhje plenare të të gjithë delegacionit dhe shpesh modifikohej. Gjithëçka duhej përkthyer edhe në versionin anglisht, megjithatë delegacioni i Kosovës ia doli, të paraqiste komente përmbajtësore për të gjitha dokumentet (Weller, 2009:219).

Rol të veçantë ka luajtur sidomos Grupi Politik, "të cilëve u ka takuar puna më e madhe" thotë Rexhep Qosja në librin e tij "Paqja e Përgjakshme". Sidomos Mehmet Hajrizi shton ai "ishte më i përkushtuari dhe më i përpikti" duke e quajtur si "mendje të rrallë matematikore". Kurse për Jakup Krasniqin Qosja do të shprehet: "Ai është si shufra e çeliktë: lakohet por nuk thyhet"(Qosja, 1999: 118).

Delegacioni me përkushtimin më të madh ka bërë vërejtjet me shkrim për çdo draft dhe aneks veç e veç, duke e vërë theksin e veçantë sidomos në ato çështje ku materializohej apo degradohej në Marrëveshje pavarësimi i Kosovës (Buja, 352:352).

Vërejtjet e delegacionit shqiptar rreth Marrëveshjes

Vërejtjet e delegacionit shqiptar ishin përqendruar pikërisht tek Korniza e Marrëveshjes. Në bashkëpunim të ngushtë me juristin e shkëlqyeshëm Marc Weller Ishte vendosur të këmbëngulej, që gjithkund ku të jetë e mundur, qoftë edhe duke e tepruar, të potencohet që kjo është Marrëveshje Kalimtare (Shala, 2001:239) Si pasojë e kësaj këmbënguljeje u arrit që edhe parimi i integritetit dhe sovranitetit të ''RFJ-së të ketë vlerë kalimtare (Tahiri, 2001:62).

Në Projekt - Marrëvehje mungonte identifikimi i ndërmjetësit dhe garantuesit Ndërkombëtar. Delegacioni i Kosovës u angazhua që SHBA-të, Anëtarët e Grupit të Kontaktit, UE, NATO dhe OSBE, të jenë nëshkruese të kësaj Marrëveshjeje dhe i njëjti subjekt ndërkombëtar të mbetet ndërmjetësues dhe garantues deri në zgjidhjen përfundimtare (Tahiri, 2001: 62). Gjithashtu synohej që në Kornizën e Marrëveshjes të inkuadrohej e drejta e popullit të Kosovës për vetëvendosje me referendum. Teksti që do të duhej të futej në marrëveshje ishte: "Tri vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes, populli i Kosovës, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, përmes referendumit do të përcaktojë statusin final të Kosovës"(Shala, 2001:239).

Përkundër këmbënguljes së gjatë e të lodhshëm, përfundimi nuk ishte tërësisht favorizues. Në fazën e fundit në Marrëveshje ishte shënuar ky tekst: "Tri vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të mbahet një takim ndërkombëtar, për të përcaktuar një mekanizëm mbi zgjedhjen përfundimtare për Kosovën, të bazuar në vullnetin e popullit, në opinionet e autoriteteve

relevante, të përpjekjeve të çdo njërës palë të cilat kanë të bëjnë me implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe të Aktit final të Helsinkit, si dhe të bëjë një vlerësim përmbajtsor të marrëveshjes dhe të shqyrtojë propozimet nga çdonjëra palë rreth masave plotësuese''(Buja, 2007:354).

Këtë formulim e përkrahnin ekspertët ndërkombëtarë duke theksuar se paraqet njohje indirekte të vetëvendosjes së popullit të Kosovës. Por delegacioni shqiptar nuk ishte i kënaqur, dhe pati një kundërshti të ashpër duke arritur gati deri te dështimi i plotë i Konferencës. Gazeta ruse ''Njezavisimaja Gazeta'' e datës 9 shkurt shkruan nga këndvështrimi rus se: Përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës në Konferencën e Rambujesë kanë paraqitur kërkesa që ''nuk janë pritur mirë'' nga treshja e ndërmjetësve ndërkombëtarë. Ata kërkojnë përcaktimin e qartë të statutit përfundimtar, zhvillimin e referendumit mbi pavarësinë e Kosovës pasi të ketë kaluar afati i periudhës së ndërmjeme dhe pjesëmarrja e NATO-s në nënshkrimin e Marrëveshjes që do të arrihet në Rambuje, duke futur këtu edhe dislokimin e forcave shumëkombëshe për garantimin e zbatimit të Marrëveshjes (Vukaj, 2007:253).

Kushtetuta (Aneksi 1)

Pa dyshim për pushtetin e mirëfilltë legjislativ në Kosovë dokumenti suprem ishte Kushtetuta. Kushtetuta parashihte një qeverisje demokratike në Kosovë përmes institucioneve legjislative, ekzekutive, juridike, si dhe institucioneve të tjera të specifikuara në të (Tahiri, 2001:63) Kjo kushtetutë jo vetëm që njihte kufijt e Kosovës, por për më tepër ndryshimi i tyre i atribohej pëlqimit të Kuvendit dhe të Presidentit të Kosovës (Shala, 2001:241).

Delegacioni i Kosovës studioi çdo fjalë, togfjalësh apo paragraf veç e veç. Kjo edhe nga fakti i paqartësive, që ishin të shprehura në këtë aneks, për çka siç dukej ishte përkujdesur vet Grupi i Kontaktit. Sigurisht, nuk ka munguar prirja për t'u shprehur qartë, por aludohej që palët më vonë të kenë hapësirë të mjaftueshme në nxjerrjen e konkludimeve të favorshme secili për veten e tyre (Qosja, 1999:118).

Megjithatë, propozimet e Grupit të Kontaktit për Kushtetutën e Kosovës ishin mjaft shpresëdhënëse. Ky dokument juridik i Kosovës tani quhej Kushtetutë, në dallim nga propozimet e para, ku ishte përdorur termi: Ligj Themeltar (Shala, 2001:240). Pastaj, kjo Kushtetutë Kosovën e bënte me Parlament, President, Qeveri dhe sistem Gjyqësor të të gjitha niveleve si dhe me Gjykatë Kushtetuese (Buja 2007:357).

Sa i përket Presidentit, kushtetuta kishte përcaktuar që Presidenti më shumë të ishte një figurë protokolare, dhe autoritet moral suprem. Duhej të zgjidhej nga vet Kuvendi. Kurse Ibrahim Rugova, propozon variantin e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës drejtëpërdrejt nga qytetarët e Kosovës. Profesor Agani ishte i vetëdijshëm se Kosovës nuk i duhej një majë e tillë kushtetore. Përvoja e tillë e Shqipërisë paskomuniste me Sali Berishën, hiç më pak edhe ajo e Kosovës me Ibrahim Rugovën nuk i jepte përkrahje një opsioni të tillë. Legjitimimi i njëshit si ato në Shqipëri dhe Kosovë ishte shumë problematik dhe madje i rrezikshëm (Shala, 2001:244). Por lakmia e njeriut për pushtet, shprehet Jakup Krasniqi në veprën e tij, është më e dëmshme për moralin njerëzor se ndryshku për hekurin (Krasniqi, 2006:173).

Grupi politik ka përgatitur vërejtjet e qarta ku synohej të dukeshin të gjitha lidhjet e Kosovës më Serbinë. “Sa më shumë të bëhej përpjekja e tëhollimit në mos të shkëputjes së plotë të lidhjeve të Kosovës me Federatën, aq më shumë do të lehtësohet rruga jonë drejt Pavarësisë”, do të shprehet Qosja para grupit politik (Qosja, 1999:118).

Formulimi gjuhësor i një marrëveshjeje është një nga detyrat më të rëndësishme të negociatave diplomatike. A arrihet të ndryshohen në favorin tënd qëndrimet politike, apo të parandalohet ndryshimi i tyre në kurrizin tënd? është parim në negociatat diplomatike (Fischer, 2008:130).

Andaj delegacioni i Kosovës ka bërë përpjekje kulmore në përcaktimin e popullit të Kosovës, si bartës themelor të pushtetësisë së Kosovës, e jo siç ishte përcaktuar në kushtetutë togfjalëshi “bashkësitë kombëtare”. E gjithë kushtetuta e Kosovës ishte e ndërtuar mbi konceptin e këtij togfjalëshi pra “Bashkësi kombëtare”. Bashkësia kombëtare në kuptimin siç merrej në këtë Kushtetutë nuk mund të ketë shtet, shprehet Qosja në librin e tij (Qosja,1999:117). Kurse Hydajet Hyseni delegacionit i shpjegoi pasojat juridike dhe politike të nocionit “bashkësi etnike” me të cilin 2 milionë shqiptarë barazohen me disa mija “egjiptianë” Andaj në të gjitha dokumente e shqyrtuara është “luftuar” trajtimi i shqiptarëve të Kosovës si popull (Qosja, 1999:102).

Të gjitha vërejtjet e bëra nga delegacioni shqiptar në draftet e Kushtetutës së përkohëshme për Kosovën, kishin për qëllim pasqyrimin e vendosmërisë së delegacionit në procesin negociator, duke treguar kështu gatishmërinë për t’u përballur me të gjitha të papriturat që mund të shkojnë në dëm të Kosovës. Për dallim nga Kushtetuta e përkohëshme, anekset tjera ishin më të drejtpërdrejta. (Buja,2007:368).

Vërejtjet në secilin aneks veç e veç

Aneksin II, ku flitej për Policinë dhe Sigurimin Publik, siç theksuam më lart ishte i panegociueshëm. Megjithatë delegacioni bëri vërejtje të rëndësishme, duke synuar arritjen e shifrës 6000 (gjashtëmijë) në forcën policore të Kosovës e jo siç ishte paraparë në aneks 3000 (tremijë) polic. Vërejtjet ishin edhe rreth afatit të tërheqjes së policisë pushtuese, që duhej të shkurtohej në më pak se një vit (Buja, 2007:369). Me leximin e kujdesshëm të kompetencave të Republikës së Serbisë në Kosovë, dilte që Serbia po e humbte jo vetëm praninë e saj policore në Kosovë, por edhe praninë politike e ate juridike (Shala, 2001:243).

Delegacioni i Kosovës ka parashtruar vërejtjet e veta edhe në anekset për zgjedhje, për Ombusdsmanin si dhe në aneksin për çështjet ekonomike, Aneksin III dhe VI. Delegacioni ishte i pakënaqur me aneksin për çështje ekonomike dhe veçmas referencave për çështjen e pronës

shtetërore (Tahiri, 2001:68).

Aneksit III, ku flitej për zgjedhjet dhe ombusdsmanit, aty shtohet vetëm: ‘’Regjistrimi i votuesve do të përfshijë edhe ata të cilët kanë të drejtë për votim, por që janë zhvendosur brendapërbrenda Kosovës, ose jashtë saj si rezultat i represionit ose konfliktit’’(Buja, 2007:370).

Kurse Aneksin IV ku trajtoheshin çështjet ekonomike, gati se ishte tërësisht i pranueshëm për delegacionin shqiptar. Megjithatë, u kërkua që Kosova të kontrollonte rrjedhat monetare në territorin e saj, nga se ndihej rreziku që mund të ketë ekonomia e Kosovës nga devalvimi i dinarit, problem që e përjetonte edhe Mali i Zi. U vlerësua edhe në inkuadrimin e Kosovës si subjekt i barabartë në sukcesionin që zhvillohej prej vitit 1991. Sa i përket aneksit ekonomik, nuk u arrit ajo që u kërkua, duke arrirë vetëm arbitrimin e disa pronave që më parë ishin në pronën shoqërore dhe shtetërore, e duke besuar në drejtësinë e arbitrit (Shala, 2001:256).

Shtylla e dytë e Marrëveshjes Kalimtare për Kosovën ishte aneksi ushtarak, i shtati me radhë në pakon e Rambujesë. Ishte i lidhur me Kaptinën e VII të Kartës së OKB-së, e cila në vecanti pëlqehej nga ambasadori Hill. Procedura e implementimit të këtij aneksi ishte e qartë: palët negociuese në këtë Konferencë do të ftonin paktin NATO të vinte në Kosovë, për të garantuar paqen dhe njëmendësimin e Marrëveshjes Kalimtare. Pastaj K.S. i OKB-së do të miratonte një Rezolutë gjithnjë në mbështetje të Kaptinës VII të Kartës së OKB-së (Shala, 2001:249).

Siç e dimë vendimin e Grupit të Kontaktit, ky aneks ishte i panegociueshëm. Megjithatë delegacioni shqiptar këmbënguli fuqishëm me forcën e argumenteve, për të bërë ndryshim edhe në këtë aneks. Aty parashihej që brenda tre muajve do të tërhiqeshin nga Kosova 50% e forcave serbe (Qosja, 1999:138).

6 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes do të mbeteshin në Kosovë vetëm 2.500 pjesëtarë të kësaj ushtrie, prej të cilëve 1000 do të qenë të logjistikës, kurse 1500, do të mbeteshin në kufi me Shqipërinë. Të gjithë këta do të jenë nën misionin e verifikuesve të OSBE-së. Kurse në Kosovë do të vendoseshin 28.000 trupa të identifikuar me shkurtesën KFOR (Buja, 2007:380).

Shqetësimi i delegacionit shqiptar qëndronte te çështja e çmilitarizimit të UÇK-së, i cili duhej të ndodhte katër muaj pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Fati i UÇK-së, dhe Referendumi ishin ndër çështjet më problemore të Marrëveshjes në Konferencë. Mbi to nuk mund të kalonte delegacioni i Kosovës. UÇK tanimë ishte bërë për shqiptarët e viseve të robëruara, e në veçanti për Kosovën simbol i shpresës dhe qëndresës së madhe. Andaj dhe për fatin e saj duhej menduar mirë sepse me të ishte mishëruar e identifikuar tërë shqiptaria (Buja, 2007:382).

Mërgata shqiptare që krenarisht identifikohej me UÇK-në, përveç ndihmave që grumbullonte në fondin e UÇK-së “Vendlindja Thërret”, me të madhe po i bashkohej UÇK-së, për ta çliruar Kosovën. Për këtë dhe delegacioni shqiptar e në veçanti të deleguarit e UÇK-së ishin të vendosur për mosprekjen e UÇK-së (Buja, 2007:383).“Nuk mund ta lëmë popullin tonë pa mbrojtje para një ushtrie gjenocidiale që shkoi deri në spastrimin etnik” shprehet Jakup Krasniqi (Krasniqi, 2006: 175). Mospajtimin e vet me çmilitarizimin e UÇK-së delegacioni e bëri të qartë, pa marrë parasysh panegociueshmërinë e dokumentit. Për këtë qëllim Delegacioni, veçanërisht përfaqësuesit e UÇK-së, zhvilluan një varg takimesh me autoritetet e konferencës, të SHBA-ve, dhe të NATO-s (Tahiri, 2001:67).

Këmbëngulej që të jetë forcë e përhershme e armatosur, qoftë edhe e vënë nën kontroll dhe trajnim të përhershëm të NATO-s; gjithashtu faza kalimtare të shfrytëzohet për trajnim dhe përgatitje profesionale, për të qenë e gatshme për fazën që do të pasonte, pra kur forcat ndërkombëtare do tërhiqeshin nga Kosova. Ishte propozuar edhe që gjatë kësaj faze UÇK'ja (një pjesë e saj) të shërbejë si Gardë Kombëtare (Buja, 2007:384).

Delegacioni shqiptar e veçanërisht të deleguarit e UÇK-së e kishin vënë në pikëpyetje tërë Marrëveshjen, po qese nuk do të respektoheshin kërkesat e tyre për UÇK-në dhe Referendumin. Kjo e involvoi edhe këshilltarin për mbrojtje të presidentit Klinton dhe sekretares së SHBA-ve znj. Olbrajt z.Xh Dobins. Në një kontakt konfidencial me Ram Bujën, z.Dobins i ofron delegacionit të UÇK-së takim me komandantin e forcave të NATO-s për Evropën, gjeneralin Uesli Klark. Takimi ishte organizuar jashtë Kështjellës së Rambujesë në një bazë ushtarake (Buja,2001:384). Gjenerali Uesli Klark disa here iu drejtua delegacionit shqiptar me këto fjalë: "Nëse serbët nuk do të nënshkruajnë Marrëveshjen, unë do t'i godas forcat e Millosheviqit në Kosovë, për këtë të jeni të sigurt". Aty gjithashtu ishte thënë që UÇK-ja duhej t'i dorëzonte armët e rënda, të mos duket në uniformë dhe të mos bëjë ushtrime klasike ushtarake.

Me gjeneralin Uesli Klark delegacioni i Kosovës është takuar edhe në përfundim të punimeve të Konferencës së Rambujesë në Paris, ku ishte vërejtur një gjendje gatishmërie e lartë ushtarake për të goditur forcat serbe. Përpjekjet e delegacionit për ardhmërinë e UÇK-së nuk u realizuan. Por u arrit një përkrahje dhe marrëveshje gjentellmene që u bë mes SHBA-ve dhe NATO-s, jo vetëm gjatë Konferencës por edhe pas saj (Buja, 2007:385).

Vërejtjet e delegacionit serb

Platforma negociatore serbe ishte e mirënjohur: Kosova duhej të mbetej së paku formalisht, pjesë e Serbisë, pushteti në Kosovë duhej të ndërtohej mbi parimin e barazisë absolute të ''bashkësive nacionale'', nuk duhej të pranonin karakterin kalimtar të statusit të Kosovës. Kurse NATO-ja, nuk duhej vendosur në Kosovë (Shala, 2001:221). Moska pjesën e sigurisë edhe atë ushtarake sipas projektit të NATO-s e kishte refuzuar. Do ta pranonim atë vetëm nëse për te shprehet pozitivisht Beogradi deklaruan rusët (Petritsch, 2002:182). Delegacioni serb ka kërkuar që të dy palët të nënshkruajnë paraprakisht paketën me dhjetë elementet bazë të Marrëveshjes me të cilat kuptohej elementet e përgjithshme (Petritsch, 2002:178). Sipas Hill ''kjo strategji e delegacionit serb për ta nënshkruar deklaratën e dhjetë parimeve pa përfundimin e marrëveshjes finale, synonte të minojë Rambujenë. Filozofija jonë është që asgjë e vecantë nuk duhet pranuar pa u pranuar e gjitha''(Milo, 2009:146). Kurse delegacioni shqiptar ishte këmbëngulës se do të nënshkruante vetëm në një dokument të vetëm (Milo, 2009:147).

Përkundër qasjes jokonstruktive të treguar gjatë gjithë kohës së negociatave delegacioni serb pranoi dokumentin pa premtimin e referendumit, që u konsiderua prej delegacionit serb, si ndërhyrje në punët e brendshme të vendit (Akademia e Shkencave, 1999:149). Referendumi për palën serbe ishte çështje më kontestuese e negociatave. Mbase, refuzimi i kësaj pike të diskutuar në Konferencë, krahas aspektit ushtarak të marrëveshjes u bë edhe shkaku kryesor i mospranimit serb për të nënshkruar Marrëveshjen (Myrtaj, 2002: 93).

Delegacioni serb gjatë negociatave për Kosovën në Rambuje kishte edhe një përparësi

evidente. Më vonë ishte marrë vesh se një anëtar rus i Grupit të Kontaktit i njoftonte ata për të gjitha rrjedhat në strukturat udhëheqëse ndërkombëtare të Konferencës edhe brenda delegacionit shqiptar të Kosovës. Kështu pala serbe kishte mundësinë e ndërtimit të strategjisë vepruese dhe ndërtimit të taktikës mbi bazën e këtyre informacioneve (Petritsch, 2002:211). Ata e dinin se e vetmja mundësi për t'u shpëtuar sulmeve të NATO-s në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes, ishte përçarja e Delegacionit të Kosovës (Weller, 2009:402).

''Duhet të dish të ndash, që të mund të sundosh'' (Qosja, 1999:256). Mosuniteti shqiptar ishte arma e fundit dhe më e forta e regjimit të Millosheviqit (Shala, 2001: 315). Për këtë ata investuan shumë. Jo rastësisht ushtria serbe intensifikoi sulmet kundër bazave të UÇK-së. Ofrimi i qeverisë franceze azil politik, për pjesëtarët e UÇK-së, gjoja për t'i shpëtuar nga rreziku që u kanoset atyre po u kthyen në Kosovë, e favorizonte strategjinë serbe (Buja, 2006:402).

Millosheviqi shpresonte se Rusia do t'i vinte në ndihmë, megjithëse kur ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë, pasi kishte shkuar në Jugosllavi kishte parë ''vetëm idiotë, të gatshëm për ta filluar luftën'' (Gecaj, 2009:57). Në anën tjeter Millosheviqi synonte të fitonte kohë që të përgatitej për sulmin e fundit. Ai kishte befasinë e tijë të parapërgatitur shumë kohë para se t'i shihin kushtet e Marrëveshjes së Rambujesë. Me operacionin "Patkoi" donte të krijonte fakte në terren të cilat do të mund ta bënin luftën ajrore të pakuptimtë. Serbët kishin gjykuar se ''Rambujeja nuk ishte negociatë. Ishte diktat i administratës së Clintonit. Nuk ishte "merr ose ler". Ishte merr ose përndryshe…''(Gecaj, 2009:60).

Dy ditë para përfundimit:

Rreziku i dështimit të konferencës

Delegacioni serb, më se dhjetë ditë nuk pranoi bashkëpunimin me Grupin e Juristëve ndërkombëtarë të Konferencës. Rrjedha e ngadaltë e bisedimeve ishte pasojë e taktikës vonuese serbe, strategji kjo e drejtuar drejtpërdrejt na Beogradi (Petritsch, 2002:184). Udhëtimi i Ambasadorit Hill në Beograd më 17 shkurt kishte rezultuar i pasuksesshëm pasi Millosheviqi kishte refuzuar ta takonte. Ai kishte deklaruar se Kosovën serbët nuk kanë për ta dhënë edhe sikur të shkatërrohet e gjithë Serbia. Millosheviqi dihej se luan fort deri në fund, por këtë herë ai po luan edhe për fatin e tij personal (Milo, 2009:153).

Me këtë Millosheviqi dëshironte ta sforconte pozicionin e tij, në refuzim të plotë të Marrëveshjes së Rambujesë, sidomos kur flitej për vendosjen e 28 mijë trupave të Paktit NATO në Kosovë. Ky refuzim pati pasoja pozitive për delegacionin shqiptar si edhe për pozicionin amerikan në këtë

Konferencë (Shala 2001:255). Pikërisht refuzimi për bashkëpunim, i delegacionit serb dhe Millosheviqit në anën tjetër, kanë ndikuar që Franca t'u afrohej pozicioneve amerikane dhe angleze (Shala, 2001:256). Dihet mirëfilli se Franca ishte gjithë kohën kundër ndërhyrjes ushtarake të NATO-s pa një mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për çka ishte deklaruar dhe më 1989 (Sopjani, 2005:9).

Më 18 shkurt të dy delegacioneve iu paraqit versioni i projektit përfundimtar i Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. ''Ky Projekt i Marrëveshjes është ai që dëshirojmë ta konsideroni përfundimtar'', shprehet Ambasadori Hill para delegacionit shqiptar (Qosja, 1999:224).

Drafti i ri ndjeshëm dallonte nga ai i 6 shkurtit. Nga prespektiva e delegacionit shqiptar, propozimi i ri ishte ndryshuar në themel, në pajtim me kërkesat që i kishte bërë Millosheviqi gjatë ekskursionit të Hillit si një parakusht për pjesëmarrje substanciale në bisedime (Weller, 2009:222). Në përgjithësi synohej një variant zgjidhjeje që i shkonte për shtat palës serbe, dhe kërkonte lëshime të mëtejshme nga shqiptarët e Kosovës (Petritsch, 2002:195). Ndryshimet më drastike dhe më të papranueshme kishin të bënin me çështjen e ''sovranitetit të RFJ-së në Kosovë'' dhe të ''themelimit të dhomës së dytë'' në Kuvendin e Kosovës (Tahiri, 2001:69).

Në esencë, propozimi i ri e riktheu çështjen e statusit juridik të Kosovës te zgjidhja kushtetuese, e kjo kërkonte zgjidhje në favor të Beogradit. Pushteti i organeve kosovare ishte ngushtuar skajshmërisht. Ishte rifutur edhe mekanizmi i vetos për pjestarët e të gjitha komuniteteve nacionale, duke mundësuar paralelizmin legjislativ në Kosovë. Delegacioni shqiptar bëri protest të ashpër, duke theksuar se paraqitja e një dokumenti të ri në substancë, dy ditë para mbylljes së paraparë të Konferencës, me gjasë si rezultat i bisedimeve të zhvilluara drejtëpërdrejt me Beogradin jashtë Kështjellës, ishte shkelje e mirëbesimit dhe se refuzonte madje edhe ta pranonte këtë dokument (Weller, 2009:223).

Janë hedhur vërejtjet tona dhe janë pranuar ato serbe. Kjo është një lojë në kurrizin tonë - do të alarmonte Rexhep Qosja. Ky është një mashtrim i madh! Duket që si edhe në Konferencat e tjera për çështjen shqiptare, edhe në këtë Konferencë në Rambuje, ne të jemi palë e dëmtuar! Nuk do pranohet kjo disfatë e përgatitur tinëzisht (Qosja, 1999:226). Kurse ''demokrati'' Drashkoviç i cili më 17 shkurt kishte shkuar në Rambuje, në një intervistë dhënë gazetës ruse ''Njezavisimaja Gazeta'' bën pyetjen: ''Përse kanë ardhur ata në Rambuje? (shqiptarët) Të kalojnë kohën? Të vazhdojnë të gënjejnë komunitetin ndërkombëtar? Ata shpresojnë se NATO do të bëhet forca që do t'u vijë në ndihmë për të krijuar shtetin etnikisht të pastër të Shqiprisë së Madhe në Ballkan'' (Vukaj, 2007:256).

Duke protestuar për ndryshimin e dokumentit në favor të palës që kishte penguar përparimin e bisedimeve deri në momentin e fundit, pala kosovare po atë mbrëmje refuzon Projekt-Marrëveshjen, duke e vënë Konferencën para dështimit vetëm dy ditë para përfundimit. Grupi i Kontaktit kishte dështuar që ta përfshinte delegacionin e Kosovës në dialog mbi dy çështje, të cilat që nga fillimi dihej se do të ishin pikat më problemore:

Referendumi për Pavarësinë, dhe Çmilitarizimi i UÇK-së (Weller, 2009:226).

UÇK-ja nuk ishte e kënaqur me idenë e çarmatimit, pjesërisht sepse nuk ishte e sigurt se mund

të mbështetej për mbrojtjen e saj te forcat e NATO-s (Clinton, 2005:713).

Faza e detajeve në shumicën e rasteve është pjesa më dinake në proceset negociuese. Është e njohur thënia ‘’Djalli qëndron në detaje’’. Vërtetë në fazën përfundimtre të bisedimeve në Rambuje ishte një fjalë e vetme ‘’Referendumi’’ e cila bllokoi tërë procesin (Gecaj, 2009:50). Çështja e referendumit ishte pika qendrore rreth së cilës delegacioni shqiptar qëndroi i bashkuar (Milo, 2009: 152). Referendumi u bë kusht i domosdoshëm për ta pranuar marrëveshjen për një zgjidhje të përkohshme, të çështjes së Kosovës. Ishte e natyrshme që delegacioni shqiptar të synojë jetësisht zgjedhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës, duke e përcaktuar në dokumentin e Marrëveshjes të drejtën për referendum (Myrtaj, 2002:93). Në Deklaratën drejtuar Grupit të Kontaktit më 18 shkurt delegacioni shqiptar shkruante: “....Delegacioni i Kosovës ia kthen këtë dokument Grupit të Kontaktit ngaqë është i papranueshëm për shqyrtim në këtë fazë të vonshme. Në fakt, dokumenti në fjalë paraqet thyerje të besimit nga ana e Grupit të Kontaktit” (Buja, 2007:388).

Në Deklaratë theksohej se delegacioni shqiptar ka pranuar që të vijë në Rambuje në bazë të asaj se në “parimet e panegociueshme” të Grupit të Kontaktit, parashihej zgjidhje kalimtare me mekanizmin për zgjedhjen përfundimtare pas periudhës kalimtare prej tre vjetësh. Delegacioni shqiptar ka pranuar projekt-dokumentet themelore për zgjidhje politike të 6 shkurtit, dhe përkundër sakrificave delegacioni i Kosovës ka negociuar në mënyrë konstruktive mbi bazën e drafteve të propozuara. Grupi i Kontaktit do të duhej të respektojë vërejtjet tona të bëra për 12 ditë. Përkundrazi Grupi i Kontaktit, 2 ditë para përfundimit sjell draftin e ri i cili paraqet shkelje të parimeve. Ky draft si nga çështja parimore edhe ajo MADHORE është tërësisht i orientuar kundër pozicionit të Kosovës, si dhe vetë propozimeve të Grupit të Kontaktit (Buja, 2007:389).

Nuk mund të ketë ndryshim të njëanshëm të parimeve më themelore. Për këtë arsye delegacioni shqiptar i Kosovës ua kthen negociatorëve ndërkombëtar draftin e ri mbi aspektet politike të zgjidhjes, si një dokument të papranueshëm si në aspektin procedural ashtu edhe përmbajtjesor. Për këtë mjafton të përmendim dy elemente madhore që e bëjnë draftin e ri të papranueshëm (Buja, 2007:390).

Nuk e pranojmë futjen e termit “sovranitet” brenda preambulës së aneksit ku theksohet se pushteti qeverisës në Kosovë buron prej Republikës Federative të Jugosllavisë (më parë përmendej vetëm integriteti i Jugosllavisë). Nuk pranojmë krijimin e dhomës së dytë në Kuvendin e Kosovës, e cila e rrit rrezikun e nënshtrimit të politikës së Kosovës ndaj përçarjeve etnike. (Bashkësi nacionale me të drejta të veçanta, që është në kundërshtim me sistemin tolerant politik në Kosovë, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët (Buja, 2007:393).

Roli i Sekretares së SHBA-ve

Në kohën kur në horizont hijezonte dështimi i Konferencës për Kosovën, në kohën kur mbi delegacionin shqiptar ushtrohej trysnia nga të gjitha anët, e sidomos mbi kryesuesin e delegacionit Hashim Thaçin që nuk po pranonte të nënshkruante shkrirjen e ushtarakëve të “tij”, dhe marrëveshjen ku nuk saktësohej Referendumi për Kosovën, në Rambuje kthehet Sekretarja e Shtetit të SHBA-ve znj, Medelin Olbrajt. Ambasadori K. Hill, e kishte ftuar znj. Olbrajt që të vinte shpejt në Rambuje! “Shqiptarët po tregohen kokëfortë si mushkat” erdhi mesazhi në Uashington, shkruan Olbrajt në librin e saj me kujtime (Albright, 2003:464).

Kur u bë e qartë disa orë para skadimit të afatit të përcaktuar, se as delegacioni i RFJ-së e as delegacioni i Kosovës nuk ishin në pozitë që ta nënshkruanin Marrëveshjen, Grupi i Kontaktit vendosi që t'i zgjaste negociatat deri në orën 15:00 të datës 23 shkurt. Ndërkohë anëtarët e Grupit të Kontaktit po shikonin me çudi në zyrën e tyre pamjen nga CNN që tregonin se si bombarduesit e mëdhenj amerikanë po barteshin në pozicione të parabombardimit, duke aluduar në arritjen e një zgjidhje nëpërmjet forcës nëse qe e nevojshme (Weller, 2009:225).

Ambasadori Hill dhe Znj. Olbrajt në takimin me delegacionin shqiptar apeluan në pranimin e Marrëveshjes sepse "në të kundërtën, as ajo e as SHBA-të nuk do të mund t'ju ndihmonin më" (Shala, 2001: 263). K.Hill këmbëngulte se në Dokumentin e ofruar nuk ka formulim që e pengon Referendumin. Por delegacioni shqiptar kërkonte formulim të qartë për mekanizmin e zgjedhjes përfundimtare të çështjes së Kosovës, pas fazës kalimtare. ''Qëndrimi ndaj referendumit duhet të saktësohet qartë, pa dilema. Këtu s'ka kompromis'' do të shprehet Mehmet Hajrizi (Qosja, 1999:240).

Trysnia e madhe që vinte nga të gjitha anët nga diplomatë, udhëheqës e atdhetarë, bënë që delegacioni shqiptar të mbetet skeptik. Mendohej se dështimi i Konferencës ishte parë qysh kur kishte filluar shkuarja dhe ardhja e anëtarëve të delegacionit serb jashtë kështjellës, e që përfundoi me ndryshimin e projekt-marrëveshjes. Presion shtesë ishte edhe shtimi i luftimeve dhe i masakrave të rënda mbi fshatrat e Podujevës si dhe zhvendosjet e detyrueshme të shqiptarëve atje (Mahmutaj, 2002:22). Kjo ishte trysni, e përgjakshme pë të nënshkruar padrejtësinë, do të shprehet Rexhep Qosja në librin e tij (Qosja, 1999:255).

Robin Kuk kishte apeluar tek pala shqiptare që të pranojë marrëveshjen. ''Marrëveshja do t'i hapte rrugë një force të madhe - do të deklarohet ai para delegacionit shqiptar'' (Qosja, 1999:242). Shqiptarët e Kosovës, në mënyrë këmbëngulëse kërkonin pavarësinë. U përpoqa t'u shpjegoj se për Kosovën nuk mund të ketë rrugë të drejtëpërdrejtë drejt pavarësisë; ambiciet e tyre ndërkombëtare duhen të ndërlidhen me zhvillimet e rajonit në tërësi, në rrugën e tij drejt BE-së. Përkundër asaj se gjeta dëgjues me qëndrim miqsor, kjo nuk vlente parasëgjithash për Hashim Thaçin me të cilin isha në gjendje të bisedoja në gjuhën gjermane, pasi ai kishte jetuar dhe studiuar në Cyrih - shprehet Fischer në librin e tij (Fischer, 2008:137).

Mesazhe përkrahëse vinin edhe nga personalitete të shquara të politikës dhe të kulturës shqiptare. Kryetari i Shqipërisë Rexhep Meidani nëpërmjet një letre, shprehte bindjen se shumica dërmuese e shqiptarëve po i mbështesin dhe mirëkuptonin qëndrimet që po mban dhe do të mbajë delegacioni kosovar (Qosja, 1999:330). Në takimet që ministri i Punëve të Jashtme Paskal Milo dhe Sabri Godo, bënë me delegacionin e Kosovës në Paris me ftesë të znj. Olbrajt, ata do të theksojnë rëndësinë e Konferencës për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, duke veçuar se përkrahja

ndërkombëtare e në veçanti ajo e SHBA-ës, duhet patur kujdes të mos humbisnin (Qosja, 1999:326).

Kryeministri i Shqipërisë Pandeli Majko nëpërmjet telefonit e porosit Hashim Thaçin se ‘’duhet ta ndëgjoni znj. Olbrajt, njësoj sikur kryeministin e Shqipërisë’’. Por, Hashim Thaçi, kryesues i delegacionit, i riu tridhjetëvjeçar para znj. Olbrajt me lot në sy do t’i thotë - jo nënshkrimit të Marrëveshjes (Albright, 2003:70). Më vonë znj. Olbrajt do të kujtojë: “Thaçi ishte një i ri, plotësisht pa përvojë, por një student me potencial të shkëlqyer për t’u bërë drejtues. Znj. Olbrajt mendonte se shkuarja e Hashim Thaçit në Slloveni, për t’u takuar me Adem Demçain gjatë kohës kur po zhvilloheshin negociatat në Rambuje kishte ndikuar për keq në qëndrimin e tij. Andaj dhe i telefonoi Demçait duke e lutur që të ndikojë pro marrëveshjes para delegacionit shqiptar. Ishte përpjekje pa sukses. Kjo ka qenë një ndër telefonatat më të tensionuara në jetën time - kujton ajo në librin e saj (Albright, 2003:471).

Në pyetjen e ambasadorit Hill, bërë Hashim Thaçit gjatë një bisede brenda Kështjellës në Rambuje, se cfarë mendimi ka për Sekretaren e Shtetit znj. Medlin Olbrajt? ai do t’i përgjigjet se ‘’interesimin e saj e ka përjetuar edhe si interesim të nënës’’ (Qosja, 1999:221). Shenja përçarëse u shfaqën edhe brenda Grupit të Kontaktit. SHBA-ja, Britania, Franca dhe Gjermania më shumë e akuzonin Beogradin për dështimin e Konferencës. Kurse Italia i fajësonte dy palët. Amerikanët e angazhuar me të gjitha forcat, bile edhe vetë presidenti Clinton, më shumë përpiqeshin t’i bindnin shqiptarët për ta pranuar marrëveshjen, e pastaj për t’i vërë serbët para përgjegjësisë së plotë - do të shprehet Paskal Milo në ditarin e tij.

Sekretarja e Shtetit, do ta luste Ministrin e Jashtëm të Shqipërisë Paskal Milo, që me një deklaratë publike të mbështesë marrëveshjen e cila në një mënyrë a në një tjetër i lejon shqiptarët që të realizojnë Referendumin. Qëndrim të qartë dhe të prerë, znj. Olbrajt paraqiti edhe para Lamberto Dinit, i cili duke ushtruar presion ndaj Thaçit, kërkonte përgjigje të prerë për Marrëveshjen, kurse Hashim Thaçi nuk përgjigjej, por mbronte të drejtën e popullit të Kosovës për pavarësi. Znj. Olbrajt do të shprehet para tyre: “Askush nuk ka të drejtë t‘jua heq shqiptarëve të drejtën për referendum e pavarësi” (Albright, 2003:48).

Ndërmjetësuesit para delegacionit të Kosovës paraqitën edhe një variant të ri i cili përjashtonte fjalën “referendum” ku thuhej: “tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të thirret një Konferencë ndërkombëtare për ta përcaktuar një mekanizëm për zgjidhje përfundimtare për Kosovën në bazë të vullnetit të shprehur të popullit, mendimit të autoriteteve të rëndësishme, përpjekjeve të secilës palë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe Aktit Final të Helsinkit, si dhe për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të zbatimit të marrëveshjes dhe për të shqyrtuar propozimet secilës palë për masa shtesë”. Në fakt ky formulim e caktonte karakterin e përkohshëm të marrëveshjes, por Konferenca Ndërkombëtare do të vendoste duke marrë parasysh interesat e të tëra palëve (serbe/jugosllave). Kosovarët u përpoqën që edhe më tutje të qartësojnë shprehjen e vullnetit të popullit, duke theksuar “populli i vet” por nuk pati sukses (Buja, 2007:399).

Sekretarja e shtetit ishte shprehur e gatshme që të shkruante edhe nënshkruante një shtojcë e cila do t’u njihte kosovarëve të drejtën për Referendum popullor, për zgjedhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Por dihej se ky dokument nuk do të kishte asnjë vlerë detyruese juridike (Petritsch, 2002:206).

Shqiptarët në Rambuje, ndjenë peshë të rëndë të përgjegjësisë historike për firmën që mund të hedhin në letër (Milo, 2009:156). Sidomos mbi kryesuesin e delegacionit dhe kryetarin politik të UÇK-së Hashim Thaçin rëndonte një përgjegjësi gjigante (Petritsch, 2002:203). Për Thaçin nuk ishte në lojë vetëm fati politik i ''vendit të tij'' por edhe mbijetesa e tij fizike (Petritsch, 2002:209). Në drekën e organizuar me delegacionin shqiptar, Olbrajt u premtoi atyre hapjen e konsullatës amerikane në Prishtinë, si dhe vizitën e UÇK-së në Uashington. Do të caktonin edhe emisar të lartë special, James Dobbins, për procesin e implementimit të Marrëveshjes së Rambujesë dhe të transformimit të UÇK-së. "Ishin këto, në fakt "karotat e fundi" të znj. Olbrajt për ne" kujton Blerim Shala në librin e tij (Shala, 2001:271).

Medelin Olbrajt, si vajzë e ambasadorit çekosllovak në Jugosllavi, pas vitit 1945 kishte jetuar në Beograd dhe nuk kishte një qëndrim aspak armiqsësor kundrejt Serbisë. Si njohëse e mirë e Ballkanit, Europës Qendrore dhe Rusisë, e konsideronte Millosheviqin, me gjithë marrëveshjen e arritur në Dayton, si një gënjeshtar të cilit nuk i besonte asnjëherë. Ajo ishte e vendosur që në Kosovë të mos lejohej një Bosnje e dytë, dhe luftonte për një zgjidhje e cila e meritonte këtë emër, dhe të mos rezultonte sërish me premtime të thyera dhe me mbushje të varrezave. Prania e fuqishme ushtarake ndërkombëtare në terren sipas saj ishte thelbi i zgjidhjes së qëndrueshme. Ajo e mbajti këtë qëndrim, përkundër kundërshtimeve në radhët e administratës amerikane, opinionit publik amerikan dhe atij evropian, duke dëshmuar në fund se kishte të drejtë. (Fischer, 2008:121).

Dita e fundit e konferencës në Rambuje

Më 23 shkurt 1999 në orën 09.30 delegacioneve të rraskapitura fizikisht dhe mendërisht iu dorëzua varianti i fundit i Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisjeje në Kosovë. Marrëveshja shoqërohej me një letër nga ndërmjetësuesit Hill dhe Petritsch (Petritsch, 2002:213). Aty thuhej se ishin marrë në konsideratë pikëpamjet e shprehura në Konferencën e Rambujesë. Më pas palët negociatore ishin njohur se Rusia nuk kishte mbështetur kapitujt 2 dhe 7, të cilat u referoheshin çështjeve ushtarake dhe të policisë. Kjo tregonte se Rusia refuzonte praninë e NATO-s në Kosovë (Tahiri, 2001:74).

Ne distancohemi nga presioni që përpiqen të ushtrojnë mbi Jugosllavinë, që me anë të forcës të marrin prej saj në mos me kulaç, me kërbaç, pëlqimin për futjen e kontigjentit ushtarak. ''Nëse NATO do të ndërmarrë veprime ushtarake kundër Jugosllavisë pa saksionet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Rusia do të prishë marrëveshjen me NATO-n dhe do të shikojë mundësinë e dhënies së ndihmës ushtarake Jugosllavisë'' do të deklarohen zyrtarët rus (Vukaj, 2008:26).

Në mesin e delegacionit shqiptar lindën kundërshtitë në mendime e qëndrime. Mendonin se ç'do të ndodhte vallë nëse Millosheviqi lëshonte pe në çastin e fundit? (Petritsch, 2002:203). LBD-ja e përkrahte kryesuesin e Delegacionit Hashim Thaçin, që ishte kundër nënshkrimit të Marrëveshjes, kurse LDK-ja pa u hamendur ishte për ta nënshkruar atë. Rugova i cili deri atëhere kishte qenë joaktiv në negociatat, me mjaft trimëri ofroi që ta nënshkruante marrëveshjen e vet, jo si anëtar i kryesisë së delegacionit por në funksionin e kryetarit të zgjedhur të Kosovës! (Weller, 2009:230). Me Rugovën isha i bindur se mund të arrinim një marrëveshje paqeje, por nuk isha i sigurt për fraksionin tjetër kryesor kosovar UÇK-në e udhëhequr nga një djalë ri i quajtur Hashim Thaçi. UÇK-ja donte pavarësinë, dhe besonte se mund ti bënte ballë ushtrisë serbe duke u përleshur drejtpërsëdrejti me te, do të shprehet Clinton në kujtimet e tija (Clinton, 2005:713).

Kur zemërimi i delegacionit kishte arritur kulmin për shkak se Hashim Thaçi nuk po pranonte të nënshkruante Marrëveshjen, Ibrahim Rugova, me fjalë të matura i drejtohet atij duke e lutur ta Pranonte Marrëveshjen. Në një rast tjeter Rugova e pyet Thaçin, se mos është parakusht për pranimin e Marrëveshjes nga ana e tij, mbështetja e Rugovës për krijimin e Qeverisë së re? (duke aluduar kështu se ai ishte i gatshëm për krijimin e Qeverisë së re me Jakup Krasniqin si Kryeministër). (Shala,2001:282).

Mehmet Hajrizi parashtron propozimin e formimit të Asamblesë, që është menduar të bëhet me LBD-në, Shoqatën e ish-të Burgosurve Politikë dhe me Lëvizjen e Studentëve. ‘’Siç jemi të bashkuar këtu, të bëjmë organin e përbashkët edhe atje’’ do të shprehet Hajrizi (Qosja, 1999:121).

Krijimi i Qeverisë së përbashkët ishte jo vetëm në interesin kombëtar por edhe ndërkombëtar sepse implementimi i Marrëveshjes së Rambujesë patjetër nënkuptonte një Qendër politike kosovare përgjegjëse për njëmendësimin e Marrëveshjes nga ana e shqiptarëve (Shala, 2001: 278). Në pajtim me propozimet që favorizonin një PO të dyfisht, shqiptarët u konsultuan për Qeverinë e re dhe u akorduan që mandati duhej të ishte nga radhët e UÇK-së. Ky propozim u përkrah nga i gjithë delegacioni (Shala, 2001:279).

Nga ana procedurale gjithëçka shkoi në rregull. Marrëveshja për Qeverinë e re u nënshkrua nga prijësit e LDK-së, të LBD-së dhe të UÇK-së, kurse “unë dhe Veton Suroi nënshkruam për të treguar përkrahjen tonë të plotë për Marrëveshjen” shkruan në librin e tij Blerim Shala (Shala, 2001: 296). Jakup Krasniqi do të kujtojë se formimi i Qeverisë së Unitetit ka qenë fitore më e veçantë e delegacionit të Kosovës, që nuk u jetësua për faktin se u bojkotua nga LDK-ja (Krasniqi, 2006: 177).

Delegacioni shqiptar i thotë po marrëveshjes

Përderisa konsensusi për aprovimin e Marrëveshjes në Konferencë, ende nuk ishte arritur, Medelin Olbrajt në vazhdimësi përsëriste përkrahjen Amerikane, “Kurrë nuk do t’ju lëmë vetëm, gjithmonë do të jemi me ju” (Shala, 2001:289). Por SHBA-ja nuk kishte në anijen e vet shqiptarët e Kosovës, apo se ata do të lëviznin pas çdo fishkëllime që vinte nga Uashingtoni. Perëndimi kishte supozuar se delegacioni serb do të dëshmohej si palë më e vështirë, në përpjekjet për të gjetur një kompromis. Por kundërshtimi i delegacinit shqiptar me gjithë fjalët e mira, lutjeve dhe kërcënimeve nga ana e delegacioneve perendimore, ishte i patejkalueshëm (Fischer, 2008:140).

Edhe Paskal Milo, i ardhur në Paris bashkë me Sabri Godon të ftuar nga vet znj. Olbrajt për ta bindur Thaçin t’i thotë “Po” Marrëveshjes, i drejtohet atij me ton të ashpër duke e kujtuar se po e kursente Serbinë nga bombardimet, dhe se duhet të ketë përgjegjësinë edhe për Shqipërinë! (Milo, 2009:161).

Çfarë befasie e madhe! - do të shprehet Fischer në librin e tij. Serbët me ndihmën e refuzimit të delegacionit të shqiptarëve të Kosovës, po nxirren nga përgjegjësitë vetëm të tyre për konfrontim ushtarak! Megjithatë Hashim Thaçi u arrit të manovrohej anash dhe delegacioni i shqiptarëve të Kosovës të jepte pëlqimin për dokumentin (Fischer, 2008:142).

Një deklaratë e kujdesshme juridikisht u përpilua aty për aty në gjuhën shqipe nga Veton Surroi, delegat i pavarur i delegacionit. Aty paralajmerohej nënshkrimi i marrëveshjes (Weller, 2009: 230).

Pranimin e Marrëveshjes Delegacioni i Kosovës e shprehu përmes letrës së vet drejtuar autoriteteve të Konferencës. Aty konfirmohet pranimi në parim i Marrëveshjes, duke shprehur gatishmërinë për ta nënshkruar brenda dy javësh pas konsultimeve me popullin e Kosovës dhe me institucionet shtetërore, politike dhe ushtarake të saj (Tahiri, 2001:74).

Në Letër thuhej:

Të gjithë anëtarët e delegacionit kuptojnë se marrëveshja do të nënshkruhet pas shqyrtimit me popullin e Kosovës dhe institucionet politike e ushtarake;

Delegacioni e pranon këtë marrëveshje siç është propozuar në tekstin e Marrëveshjes më 23 shkurt, me saktësime teknike;

Delegacioni i Kosovës pret vendosjen e shpejt të NATO-s në Kosovë;

Delegacioni i Kosovës vëren se pas periudhës kalimtare trevjeçare, Kosova do të mbajë referendum për të verifikuar vullnetin e Popullit, siç parashihet në Marrëveshje;

Delegacioni i Kosovës konstaton se UÇK-ja do të kyçet në një proçes të transformimit duke pasur siguri për një bashkëpunim bilateral në zbatimin e këtij proçesi, në pajtim me Marrëveshjen (Qosja,1999:336).

Më 23 shkurt, shqiptarët kosovarë, përfshirë Thaçin e pranuan marrëveshjen në parim. U kthyen në shtëpi për ta miratuar me njerëzit e tyre (Clinton, 2005. 713). Kjo i dha frymëmarrje dhe kohë delegacionit shqiptar, e kryesisht Hashim Thaçit e drejtuesve të tjerë të UÇK-së që të ktheheshin në Kosovë, të bisedonin me komandantët e njerëzit e terrenit dhe pastaj të merrnin një vendim të pjekur mirë (Milo, 2009: 164).

Delegacioni i Kosovës hartoi edhe dy shkresa, për çështjet më problemore të marrëveshjes. Njëra iu adresua bashkëkryetarëve dhe negociatorëve, dhe tjetra diplomates Medelin Olbrajt. Kurse Franca dhe Britania, para opinionit paraqitën në mënyrë pozitive rezultatet e Konferencës. Por të gjithë e kishin të qartë, se atë që nuk arriti të ofrojë Konferenca e Rambujesë, tani duhej përpjekur të arrihej në takimet e drejtpërdrejta me Millosheviqin (Fischer, 2008:143).

KAPITULLI III:

DELEGACIONI SHQIPTAR KTHEHET NË ATDHE PËR TË MARR MENDIMIN E POPULLIT

Dorëheqja e Adem Demaçit

Në Rambuje po bëhej një "Luftë" e përmasave që pa dyshim për popullin e Kosovës shtrohej pyetja shekspiriane "të jesh a të mos jesh", ndërsa në Kosovë Adem Demaçi, kishte marrë rolin e komandantit suprem dhe po merrej me shkarkime e emërime në radhët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai e hodhi poshtë Marrëveshjen e arritur në Rambuje, dhe më 22 shkurt merr kontrollin e plotë politik mbi UÇK-në. Sipas Demaçit "dokumenti i Rambujesë e fut Kosovën nën Serbi një herë e përgjithëmonë" (Shala, 2001:301). Me këtë logjikë ai mendonte që

duheshin bërë edhe disa ofensiva ushtarake të cilat pa tjetër do t'i fitonte UÇK-ja, e pastaj të shkohej në Konferencë me pozita të përforcuara nga fitoret në fushë lufte me armë. Kjo do të përforconte pozitën e negocimit të shqiptarëve në Konferencë.

Pas kthimit të delegacionit shqiptar nga Rambujeja, ky problem u zgjidh qysh në mbledhjen e parë të kreut të UÇK-së, të mbajtur më 26.02.1999 (Krasniqi, 2006:180). Më 2 mars Adem Demaçi, publikisht jep dorëheqje nga pozita e përfaqësuesit politik të UÇK-së, duke nënkuptuar fitoren e Krahut të Jakup Krasniqit. Beogradi i cili para medieve e opinionit të gjerë, pas Konferencës kishte shpallur ngadhënjimin e tij në Rambuje, tani Marrëveshjen Kalimtare për Kosovën e shpalli "inekzistente" (Shala, 2001:305).

Delegacioni shqiptar i shpjegoi popullit në Kosovë rrjedhat e Konferencës së Rambujesë. Duhej marrë bekimi i tij për ta nënshkruar Marrëveshjen siç ishte paraparë. U demantuan gjithashtu thashethemet, se në Rambuje po ngjallej pacifizmi, përderisa ai na qenkej shtrirë për tokë. Në Rambuje jo vetëm që s'është ngjallur pacifizmi por aty iu dha grusht i fortë (Krasniqi, 2006:184). Kurse Hashim Thaçit si udhëheqës i Drejtorisë Politike iu desh të udhëtojë në këmbë nëpër malet e Kosovës, për të kryer detyrat e tij, duke shpjeguar nëpër të gjitha zonat e UÇK-së për rëndësinë e dokumentit të Rambujesë (Buja, 2007:411).

Përfaqësuesit e UÇK-së gjatë kësaj kohe patën takime të shumta edhe me përfaqësues të shumtë të shteteve të ndryshme, kryesisht anëtarë të Grupit të Kontaktit. Më 28 shkurt ishte realizuar takimi me Ambasadorin e Britanisë së Madhe i akredituar në Beograd (në fshatin Lladroc, më 1 mars me Kryetarin e Komitetit Ndërkombëtar të Helsinkit (në fshatin Banjë), më 2 mars me mikun e madh Shon Bërns, përfaqësues i Misionit Verifikues në Kosovë KDOM-it (në fshatin Lladroc), më: 5 mars me përfaqësues të BE-së z. Petrich dhe z. Paulls (në fshatin Tërstenik), më: 6 mars me shefin e Misionit Verifikues në Kosovë z. Uolker (në fshatin Drenoc), më 8 mars me z. K.Hill dhe delegacionin e tij (në fshatin Drenoc) e takime të tjera ku u bisedua për rrjedhat e Konferencës së Rambujesë dhe mundësitë e nënshkrimit të marrëveshjes në Paris (Buja, 2007: 412).

Edhe Shqipërinë e vizituan udheheqës të shumtë shtetëror, me qëllim për të kuptuar se çfarë po mendonin shqiptarët për nënshkrimin e marrëveshjes. Përderisa ministri i Jashtëm Rus kishte përsëritur retorikën e tij të njohur për zgjidhjen e çështjes së Kosovës brenda tërësisë territoriale të Jugosllavisë, Ministri Jashtëm gjerman Joshka Fisher do të shprehet në Tiranë se mosnënshkrimi i marrëveshjes do të ishte gabim historik pë rshqiptarët. Ai ishte i bindur se Marrëveshja do të nënshkruhet nga serbët, ''sepse ata janë të vetëdijshëm se çfarë rrezikojnë me mosnënshkrimin e saj'' (Milo, 2009:168). Kurse në takimin që pati ministri i Jashtëm grek Jorgos Papandreu me Pandeli Majkon, Kryeministrin shqiptar në Tiranë, ky i fundit do t'i thotë qartë Papandreut se: ''Nëse do të fillojë masakra në Kosovë, të gjithë shqiptarët do të orientohen nga zgjidhja e armatosur, dhe i gjithë ky reaksion do të përhapet në Maqedoni dhe Mal të Zi. Sinjalet vijnë edhe nga Turqia, ku numërohen 4-5 milion shqiptarë. Vetë unë do të shkoj në front'' (Milo, 2009:170).

Zyrtarizim i Marrëveshjes

Delegacioni i Kosovës pas marrjes së përkrahjes nga populli, më 13 mars u nis për ta nënshkruar Marrëveshjen në Paris. Kësaj here delegacioni ishte i vendosur në Hotelin ''Sofitelj'', në

qendër të Parisit. Që në fillim ndërmjetësit kishin bërë me dije se nuk do të lejohej që çështja të zgjatej si në Rambuje (Akademia e Shkencave,1999:146). Përkundër asaj se Hashim Thaqi kishte folur me telefon me Medelin Olbrajt, duke e garantuar atë për nënshkrimin e marrëveshjes, amerikanët duke patur një përvojë të hidhur me Thaçin nga Rambujeja e kërkuan garancinë me shkrim. Hashim Thaçi u kishte dërguar letra garancie, në fillim M. Olbrajtit më vonë edhe bashkëkryetarëve të konferencës, Vedrin e Kuk, si dhe ministrit të Jashtëm gjerman J. Fisher. Klinton për këtë do të shprehet: *''Jam shumë i kënaqur që shqiptarët kanë rënë dakort që të nënshkruajnë marrëveshjen e paqes. Inkurajoj edhe zotin Millosheviq që ta bëjë të njejtën gjë, por nëse serbët refuzojnë, nuk na mbetet ndonjë zgjidhje tjetër përveç forcës''* (Milo, 2009: 173).

Kurse gazeta ruse ''Njezavisimaja Gazeta'' në prag të nënshkrimit të Marrëveshjes në Paris do të shkruajë se ''SHBA-të kanë planifikuar një shpërbërje të re të Jugosllavisë''. Kjo gazetë sulmonte SHBA-të se kanë përpiluar një plan shtesë sipas të cilit NATO-ja planifikon të krijojë kushte për ta shkëputur Kosovën nga Serbia. Sipas kësaj gazete ''Janë të mundshëm tre variante. I Pari: Kosova i bashkohet Shqipërisë. I Dyti: Kosova bëhet shtet i pavarur, i kontrolluar nga Shqipëria dhe mbas pak kohe ai do të kalojë nën drejtimin e plotë të Tiranës. I Treti: Kosova ndahet në pjesën serbe (më e vogla) dhe shqiptare (më e madhja).'' Ky shkrim synonte të justifikonte Beogradin, i cili me gjithë kërkesat e komunitetit ndërkombëtar përfshirë edhe Rusinë, ''e cila nuk po mundte ta thyente Millosheviqin'' kishte vendosur të mos e nënshkruante marrëveshjen (Vukaj, 2007:281).

Sigurisht Serbët nuk do të nënshkruajnë Marëveshjen e cila e nxjerr Kosovën jashtë sundimit të tyre, që i privon ata nga shfrytëzimi i burimeve të Kosovës, që u jep fund përpjekjeve historike serbe për të shfarosur shqiptarët nga trojet e tyre dhe që i bën ata të përmblidhen përfundimisht në shtëpitë e tyre historikisht të njohura (Milo, 2009:106).

Në pyetjen bërë K.Hillt, se çfarë mendonte në rastin kur serbët nuk do të nënshkruanin marrëveshjen. K.Hill përgjigjet se as nuk do të nxitoheshin, por as edhe nuk do të vonoheshin. Megjithatë Hill i quan delikate dhe shumë të rrezikshme dhjetë ditët e ardhëshme në Kosovë (Milo, 2009:176). Më 18 mars u bë nënshkrimi i njëanshëm i Marrëveshjes së Rambujesë në Paris, në qendrën Kleber, ku pala serbe e as rusët nuk ishin të pranishëm (Fischer, 2008:146). Nënshkrimi u realizua nga ana e shqiptarëve, SHBA-ve dhe të BE-së (Gecaj, 1999:59).

Për këtë përfaqësuesi rus B. Majorski do të shprehet: ''Një nënshkrim nuk e përfundon marrëveshjen. ''Tangoja luhet bukur vetëm kur e vallëzojnë dy vetë''. Kurse Drejtori i departamentit të shtypit dhe informacionit në MPJ ruse deklaroi se ''Dështimi i bisedimeve të Parisit për

rregullimin e krizës në Kosovë mund të ketë pasoja të rënda për Ballkanin'' (Vukaj, 2007: 287).

Rambuje i ofronte Serbisë mundësinë e fundit që ta mbante Kosovën brenda territorit të vet shtetror, nëpërmjet një zgjidhje politike, të siguruar me praninë ushtarake në terren (Fischer, 2008: 137). E nëse do të shkaktohej luftë, atëhere Serbia do ta humbiste përfundimisht Kosovën - shprehet Fischer në librin e tij (Fischer, 2008: 138).

Në Rusi diskutohej se Ministri i Jashtëm Ivanov mund të shkonte përsëri në Beograd për ta bindur Millosheviqin për të nënshkruar marrveshjen, madje me një mesazh tepër të shkurtër ''nënshkruaj ose je i humbur''! Në këtë kohë sondazhet në Serbi tregonin se 62.5 % e serbëve besojnë se në rast sulmi të NATO-s kundër Jugosllavisë, rusët do të ngrihen në mbrojtje të tyre. Asaj do t'i vinte në ndihmë Fronti i Forcave Popullore Patriotike të Rusisë. Në fakt, lideri i PLD-së ruse Zhirinovski në Rusi para ambasadës amerikane do të organizonte miting proteste, me parullen ''Serbët i besojnë Zotit në qiell dhe Rusisë në tokë''. Kurse vetë Zhirinovski para protestuesve do të deklarojë se '' mijëra rusë janë gati të shkojnë në Serbi, dhe të fillojnë luftën kundër NATO-s agresore'' (Vukaj 2007: 288).

Nënshkrimi nga ana e delegacionit shqiptar i Marrëveshjes për Paqe, në Kosovë vlerësohej dhe si nënshkrim i aleancës së Kosovës me SHBA-të (Tahiri, 2001:10). Apo siç do të shprehet Rexhep Qosja në vepren e tij, për aleatët e shqiptarëve, ''Dorzanë më të fortë se ç'ka pala shqiptare sot nuk ka pasur asnjë palë gjatë historisë. Kjo është një dhuratë e Zotit. Ata që nuk janë në gjendje ta çmojnë si duhet këtë dorëzani, ata nuk kuptojnë ç'ka ngjarë në Ballkan gjatë 150 vjetësh të shkuara dhe nuk do jenë në gjendje të kuptojnë as çka mund të ngjasë në Kosovë gjatë 150 ditëve të ardhshme'' (Qosja, 1999: 396).

Delegacioni shqiptar lëshoi një deklaratë spjeguese e cila theksonte se ata e konsideronin NATO-n si zbatuesin qenësor dhe se kuptonin që, pas një periudhe kalimtare prej tri vitesh, kosovarët do të mund të shprehin lirshëm vullnetin e tyre për statusin e ardhshëm përmes një referendumi. Të nesërmen pas nënshkrimit, bashkë-kryesuesit francezë dhe britanikë theksuan se ''Marrëveshja e Rambujesë ishte e vetmja zgjidhje paqësore e problemit të Kosovës'' (Gecaj, 2009: 60).

Pas gjithë kësaj, i ftuar nga shtabi i NATO-s, delegacioni shqiptar u informuan për gatishmërinë e NATO-s për sulmet kundër trupave serbe. Në pyetjet e Delegacionit, se sulmet e NATO-s do të pasohen me hakmarrje të tmerrshme nga forcat serbe, Gjenerali Clark do të përgjigjej: "Nuk mund të mbrojmë çdo shtëpi në Kosovë dhe çdo qytetar, kjo është vështirë për ju, por në fund të fushatës sonë, do të bëhet mirë për ju". Në këtë takim, shqiptarët u bindën se tani më nuk kishte as një mëdyshje se serbët do të goditen nga NATO-ja dhe as Zoti nuk mund t'i shpëtonte nga këto sulme (Shala, 2001: 333).

Në anën tjetër Millosheviqi me kohë po i përforconte forcat serbe në kufi me Kosovën. Ai synonte të krijonte fakte të kryera në Kosovë, duke shfrytëzuar ushtrinë dhe njësitë famëkeqe paramilitare serbe. Me një fjalë në Beograd ishte marrë vendimi për luftë (Fischer, 2008:153). Përderisa serbët filluan një ofensivë të spastrimit e të krimit në Kosovën Qendrore dhe Veriore, Këshilli i NATO-s vazhdoi të qëndronte i mbledhur duke diskutuar detajet e aksionit për sulm mbi forcat ushtarake serbe (Milo, 2009: 179). Pyetjes se si mendonte Millosheviqi të arrinte sukses me

politikën e vet të spastrimeve etnike, me gjithë izolimin ndërkombëtar që u ishte bërë dhe unitetin e Perëndimit, edhe sot e tutje mbetet pa përgjigje! Për NATO-n dhe Perëndimin më nuk kishte kthim mbrapa (Fischer, 2008:146).

Qeveria e Unitetit

Delegacioni shqiptar në Rambuje, Marrëveshjes për Paqe dhe vetadministrim në Kosovë, e kishte parë të arsyeshme t'i thuhet ''Po''; bashkë me të, edhe formimit të një qeverie të unitetit, ku do të mundësohej një qendër vendosjeje, për të arritur më lehtë zbatimin e vendimeve të Konferencës. Kjo jo vetëm se do të realizonte më shpejt paqen në Kosovë, por do t'i rriste kredibilitetin faktorit shqiptar para ndërkombëtarëve. Ibrahim Rugova përkundër nënshkrimit për pajtueshmërinë e krijimit të Qeverisë së Unitetit, nuk pranoi të jetë pjesë e asaj qeverie ku ishin luftëtarët e lirisë (Buja, 2007:424). Koha do të na tregojë se ata që e kishin sabotuar luftën po e sabotonin edhe bashkimin e faktorit shqiptar (Krasniqi, 2006:194).

Delegacioni i Kosovës
Takimi në Rambouillet

Rambouillet,
23 shkurt, 1999

Delegacioni i Kosovës në Konferencën e Rambouilletit, pas konsultimeve me grupimet politike e ushtarake: Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës, Lëvizjen e Bashkuar Demokratike, si dhe me dy anëtarët e vet të pavarur, më 23 shkurt 1999

Vendosi

1. Të formohet qeveria e përkohshme e Kosovës.
2. Qeveria do të qeverisë deri në zgjedhjet e para të lira në Kosovë.
3. Mandatar i qeverisë, me marrëveshje, u caktua z. [illegible]
4. Tri grupimet politike do të kenë përfaqësim të barabartë në Qeveri, duke i shtuar këtij numri edhe mandatarin, si dhe anëtarë të tjerë të mundshëm të pavarur.

Për UÇK-në
z. Hashim Thaçi

Për LDK-në
Dr. Ibrahim Rugova

Për [illegible]
Akad. Rexhep Qosja

Marrëveshja për formimin e një qeverie të unitetit - 23 shkurt 1999.

Megjithatë në prill u formua Qeveria e Përkohshme e Kosovës, me kryeministër Hashim Thaçin. Në aspektin formal kjo ishte përmbushje e Marrëveshjes së arrirë në Rambuje. Ndërkohë Ibrahim Rugova u morr në arrest shtëpiak nga forcat serbe në Kosovë, duke u favorizuar kështu me alibinë për mospjesëmarrje në Qeverinë e Unitetit (Shala, 2001:366). Edhe Edita Tahiri gjatë bombardimeve të NATO-s do të merrej me spekulime, dhe të pavërteta, kundër marrëveshjes për Qeverinë e Unitetit (Shala, 2001:326).

Më 18 maj 1999, Kryeministri Britanik Toni Bler gjatë vizitës së tij në Shqipëri, për 40 minuta ishte takuar me përfaqësuesit e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, në Ambasadën Britanike në Tiranë. Kryeministri Bler do të ritheksoi nevojën për unitetin e faktorit shqiptar duke e përmendur si bazë të kësaj Marrëveshjen e Rambujesë (Blair, 2005:142).

Ibrahim Rugova, pas lirimit nga arresti shtëpiak që i kishte bërë regjimi i Millosheviqit, ishte strehuar në Itali bashkë me familjen e tij, përkundër ftesës që Qeveria e Tiranës i kishte bërë për të shkuar në Shqipëri. Paskal Milo nëpërmjet ambasadorit shqiptar në Romë organizon takimin me Rugovën. Ky e falenderon për ftesën e bërë nga Qeveria shqiptare për t'u strehuar në Tiranë, që edhe do ta bëjë, por pasi t'i ketë përfunduar disa takime ndërkombëtare!!! (në fakt ai nuk shkoi në Tiranë kurrë më) Përshëndet edhe propozimin për të mbledhur gjithë faktorin politik të Kosovës në Tiranë, dhe shtoi "do të bisedoj me bashkëpunëtorët e mi të shpërndarë". Sa i përket Marrëveshjes për krijimin e Qeverisë së përkohëshme të arritur në Rambuje, ai la të kuptojë se u kishte lëshuar pe njerëzve të UÇK-së për hir të unitetit - shprehet P. Milo në librin e tij (Milo, 2009:217).

Kosova fitoi në Rambuje

Millosheviqi pas gjithë luftrave të shkaktuara në ish-Jugosllavi, e kishte humbur besimin para bashkësisë ndërkombëtare. Të kujtojmë me këtë rast znj. Ollbrajt kur theksonte se ''Millosheviqi ishte një gënjeshtar të cilit nuk i besohej'' (Fisher, 2008:121). Apo edhe ministri i Jashtëm Rus, kur pas vizitës së tij bërë Millosheviqit deklaroi se ''nuk kishte parë tjetër përveç se ''idiot të gatshëm për të filluar luftën'' (Gecaj, 2009:57). Kurse Toni Bler alarmonte se Millosheviqi vizionin e tij mesjetar, e bëri ferr real në Evropën moderne (Blair, 2005: 65).

SHBA-të dhe Britania e Madhe ishin të vendosura për ta ndëshkuar Millosheviqin në papërgjegjësitë e tij me erë lufte. Edhe Gjermanët kishin të njëjtin mëndim. Më pak francezët dhe më keq ishin italianët që e kanë konfliktin te dera e shtëpisë. Kurse rusët nuk donin të vijë deri te kjo pikë. Rusët jo vetëm se nuk mund ta bindnin Millosheviqin, as nuk donin të krijohej një precedent që nesër mund të përdorej kundër tyre; ata i frigonte humbja e influencës dhe goditja e prestigjit e krenarisë si superfuqi ushtarake. Kjo kishte ndikuar që diplomacia ruse në Rambuje të bëjë përpjekje maksimale për të mbrojtur sundimin e serbëve në Kosovë (Vukaj, 2007:289).

Kryesuesi i konferencës Joschka Fischer në librin e tij shkruan se, ishte munduar t'ia qartësojë situatën dhe të gjejë rrugëdaljen më saktësisht me Marrëveshjen e Rambujesë. I thashë se SHBA-në Jugosllavia nuk do ta fitonte kurrë, siç nuk e kishte fituar as Gjermania në dy luftërat e zhvilluara në këtë shekull, përveç përjetimit të katastrofës kombëtare. Kurse miqtë Rusë nuk do të rrezikonin për hatër të tij, e as Kina. Por Millosheviq ishte i mendimit se SHBA-ja qysh në Vietnam u desht t'i kuptojë kufijt e pushtetit të vet, dhe se kjo përvojë e tyre do të përsëritej edhe në Jugosllavi! (Fischer, 2008:144). Ai shpresonte se kosovarët nuk do ta nënshkruanin marrëveshjen, duke besuar gjithashtu në shpërthimin e kundërshtive në gjirin e NATO-s, për tu mos u vërë në jetë kërcënimi për veprim ushtarak (Petritsch, 202:221). Nuk i besonte seriozitetit të Perëndimit për të përdorur forcën kundër makinës së tij të luftës, në mbrojtje të shqiptarëve të pafajshëm (Blair, 2005:7).

Një vendim jo i papritur por i befasishëm, do të vijë më 27 maj nga kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Louise Arbur, e cila publikoi padinë kundër Millosheviqit nën akuzën për krime lufte, me çka Millosheviqi përfundimisht nuk ishte më partner i drejtëpërdrejtë në negociata. Ishte vendim pa asnjë trysni politike. Po të ishim pyetur ne, shprehet Joschka Fischer në librin e tij, kjo padi do të ishte shtyrë edhe për një kohë, derisa të arrihej një pajtim me Beogradin (Fischer, 2008:227).

Tërë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për ta bindur Millosheviqin të pranonte

Marrëveshjen e Rambujesë rezultuan të kota. Serbosllavët kurrë nuk njohën gjuhën e diplomacisë. Millosheviqi nënshkroi 18 marrëveshje për armëpushim, dhe asnjë nuk e respektoi kurrë. Ballkani është mbushur me marrëveshje të nënshkruara por të parealizuara (Blair, 2005:37). Ai nuk respektoi edhe 73 Rezoluta të miratuara nga K.S. i OKB-së (Fischer, 2008:221).

Edhe konferenca në Rambuje dështoi, sepse nuk u nënshkrua nga dy palët. Kurse pjesëmarrja serbe në bisedimet për paqe në Kosovë në Rambuje, ishte mburojë për përgatitjet për sulm të Millosheviqit shprehet Toni Bler në librin e tij (Blair, 2005:34).

Sulmet ajrore të NATO-s që pasuan mbi trupat serbe në Kosovë, ishin pasojë e dështimit të diplomacisë për zgjidhje paqësore të konfliktit. Ushtria serbe ofensivën e vet ushtarake tokësore në Kosovë e kishte filluar më 20 mars 1999, NATO-ja e filloi fushatën e vet ajrore më 24 mars1999 (Fischer, 2008:155).

Më 24 mars, e informova popullin amerikan për atë që po bëja dhe pse. U shpjegova se Millosheviqi u kishte privuar kosovarëve të drejtat që u garantonte kushtetuta. Përshkrova krimet e shëmtuara të kryera nga serbët. Më së fundi, i vura ngjarjet aktuale në kontekstin e luftërave që Millosheviqi kishte bërë tashmë kundër Bosnjës dhe Kroacisë dhe të ndikimit shkatërrimtar të masakrave të tij mbi të ardhmen e Europës (Clinton, 2005:714).

"Nuk do të ketë asnjë dyshim në vendosmërinë tonë për t'u dhënë fund vrasjeve në Kosovë" do të deklaronte Kancelari gjerman Gerhard Schroder në fjalimin e tij drejtuar gjermanëve. Vetëm realiteti i forcës mund ta ndalon Millosheviqin në realizimin e operacionit të tij famëkeq "patkoi" për spastrimin e Kosovës nga shqiptarët dhe jetësimin e ëndrrës së tij për Serbinë e Madhe. (Blair, 2005:7). Më pas edhe Këshilli i BE-së, i tubuar në Berlin, unanimisht miratoi Rezolutën me të cilën shprehej përkrahja e pa rezervë e NATO-s (Fischer, 2008:161). Kurse Marc Weller për reagimin ndërkombëtare në Kosovë, thotë se, me këtë u nis një formë e re më e avancuar në politikën ndërkombëtare (Weller, 2009:35).

Operacioni i NATO-s mbi trupat serbe zgjati 78 ditë, dhe tërësisht ishte i bazuar në sulmet ajrore. Realizoi 30.000 fluturime. Vetëm dy avion kishin humbur (Clinton, 2005:721).Ata avjonë të bardhë me shpejtësi drite kosovarët i shihnin nga poshtë herë si balet qiellor i lirisë, herë si ëngjëj lirie dërguar më në fund nga Zoti në ndihmë të tyre. Në rast të moskapitullimit të forcave ushtarake të ish-Jugosllavisë në Kosovë parashihej edhe ndërhyrja me trupa tokësore të cilat ishin pozicionuar në vendet fqinje të ish-Jugosllavisë. Në të njejtën kohë një mision të tillë të trupave tokësore, po e kryente me sukses UÇK-ja. Millosheviqi gabimisht kishte llogaritur në dobësimin e uniteti të NATO-s (Blair, 2005:48).

Goditja e forcave të NATO-s vazhdoi deri në kapitullimin e Millosheviqit më 9 qershor 1999. Po at ditë u realizua edhe marrëveshja e tekniko-ushtarake, në aeroportin e Kumanovës në Maqedoni të kontrolluar nga francezët, mes gjeneralit britanik Mike Jackson dhe gjeneralit serb Marjanoviq. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë që përshëndeste përfundimin e luftës dhe unë e njoftova popullin amerikan se fushata e bombardimeve kishte mbaruar, forcat serbe po tërhiqeshin dhe një milion burra, gra dhe fëmijë të nxjerrë me forcë nga tokat e tyre do të mund të ktheheshin në shtëpi shprehet Clinton në kujtimet e tija (Clinton, 2005:721). Për herë të parë pas 100 vitesh pushtimi, Kosova frymoi pa çizmen serbe. NATO-ja, mbeti fuqi parësore

ushtarake për të garantuar sigurinë në Kosovë, kërkesë kjo këmbëngulëse e delegacionit të Kosovës, në Rambuje.

Populli i Kosovës, më në fund, duke përballuar padrejtësi pas padrejtësie, dhune dhe gjenocidi shtetëror serb, i martirizuar si asnjë popull tjetër, po frymonte lirinë. Ideali kombëtar i ruajtur ndër breza, i kultivuar dhe farkëtuar nëpër kalvaret më të tmerrshme të sakrificës dhe vetëmohimit u jetësua. Vendosja e Kosovës nën protektoratin ndërkombëtar dhe administrimi i saj sipas rezlutës 1244, do të zgjasë për një kohë deri në shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran më 17 shkurt 2008, Duke u plotësuar kështu amaneti i aq breza martirësh me mundime e përgjakje biblike për lirinë. “Atdheu është formuar nga hiri i martirëve” thotë La Martini, thua këtë e thotë veçanërisht dhe për Kosovën.

Përmbyllje

“**Vdekja për lirinë e Kosovës do të ishte fati im më i madh i jetës**”, tha duke buzëqeshur Fehmi Lladrovci para gazetarëve të huaj, pak para se ta vriste makineria fashiste serbosllave. www.iszene.com. Ishte kjo ëndërra e shumë brezave të kombit shqiptar, të cilët për të mbrojtur tokën e të parëve në altarin e lirisë sakrifikuan edhe jetën e tyre. Pushtues lakmitarë, perandorë e mbretëri, synuan vargmalet dhe bregdetin shqiptar, synuan kombin shqiptar në zemër të Evropës, por pa arritur kurrë ta nënshtrojnë plotësisht. Si rrallëkush, shqiptarët gjunjët s’i kanë për t’u thyer po për t’u ringritur më këmbë. Pushtuesit kaluan mbi tokat shqiptare pa lënë gjurmë, ‘’siç kalon uji mbi shpinën e rosës’’ do të shprehet Edit Durham, studiuese dhe mike e madhe e shqiptarëve. Dhuna dhe genocidi serb vazhduan deri në kohët tona të modernizmit global, e në qendër të Europës së qytetëruar. Gjakderdhjen ai e nisi me të tjerët, pasi e dinte që Kosova shqiptare është kockë e fortë, dhe atë nuk e kapërdinte dot pa mbaruar punë me republikat sllave.

Goditja kundër vrasësve serbë për prishjen e Jugosllavisë si xhaketë anakronike me gjashtë arna, nisi nga Kosova, dhe krimi i Beogradit histerik do të mbyllej me Kosovën. Llogaria qe bërë saktë. Për të shkulur rrënjët (siç janë shqiptarët), më parë duhen qëruar ferrat e drurët më të hollë rrotull rrënjës ngulur thellë në tokën e vet. Kaluan vite dhe rrimë e gjykojmë. Rambujeja, një emër që tanimë, të paktën për shqiptarët i kaloi historisë, qe pika ku ajo mblodhi të kaluarën dhe rezatoi të ardhmen e Kosovës. Nuk kish vënd më të përshtatshëm sesa zyra e kësaj zgjidhjeje dramatike të vendosej në një kështjellë! Dikur Aleksandri i Madh “Nyjën Gordiane” që i shtruan përpara për zbërthim, ai e zgjidhi me shpatë. Beogradi zyrtar i bërë nyjë makabre nga Millosheviçi, u pa se nuk mund të zgjidhej ndryshe veçse me “shpatë 2 (në gjuhën e kohës - me avionët lirisjellës të NATO-s). Rambujeja e vendosi saktë këtë version. Sigfurisht lëvizjet e shqiptarëve në delegacion kishin dhe forma dramash në skena, pasi shqiptarët nuk qenë mësuar kurrë të ftoheshin kështu në tryezat diplomatike të Europës, as kur vendosej fati i tyre. E shumta ata prisnin në oborret e diplomacisë te dera. Aktorë kryesorë të delegacionit kishin me vete erë armësh prej nga vinin, dhe Kështjella Rambuje si kështjellë i pranoi dhe ashtu, kur në krah i pranonte sidomos dërgata e Shteteve të Bashkuara. Këto zikzake lëvizjesh të delegatëve tanë, siç i thamë sadopak, kishin skica drame pasi ridhnin nga tragjedia e gjatë e Kosovës së tyre. Sidoqoftë, ata Mbledhjes historike të Rambujesë dhe zhvillimeve më pas gjer në Pavarësinë e Kosovës i dhanë një vulë të veçantë e të paharrueshme humanizmi e drejtësie që bota rrallë e kish parë në ballafaqimet diplomatike apo ushtarake. NATO’ja për herë të parë pas 4o vitesh të jetës së saj armët i përdori për Kosovën, si

për të larë dhe një borxh që Fuqitë e Mëdha i kishin kombit shqiptar në martirizimet që i kishin bërë. Më saktë e më bukur, këtë gjë e gjykon figura enciklopedike e disidentit dhe antikomunistit çek, Vaslav Havel: "Është lufta e parë që nuk u zhvillua në emër të interesave, por u bë në emër të parimeve e vlerave. Në këtë kuptim, Lufta e Kosovës qe një luftë etike. Aleanca botërore luftoi në emër të njerëzores edhe për njerëzit e tjerë". Ne jemi krenarë edhe për këtë Luftë, edhe për këtë vlerësim.

Bibliografia

- *Krasniqi Jakup, Kthesa e Madhe, Gjon Buzuku, Prishtinë; 2006*

- *Qosja Rexhep, Paqja e Përgjakshme, Toena, Tiranë; 1999*

- *Çami Muin, Shqipëria në Rrjedhat e Historisë, Onufri, Tiranë; 2007*

- *Reuter Jans, Shqiptarët në Jugosllavi, Botimpex, Tiranë;2003*

- *Hajrizi Mehmet, Histori e një Organizate Politike dhe Demonstratat e vitit 1981, Toena, Tiranë; 2008*

- *Durham Edit, Brenga e Ballkanit, Naum Veqilhaxhi, Tiranë;1998*

- *Buja Ramë, Çështja e Kosovës dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë, Universiteti AAB, Prishtinë, 2007*

- *Shala Blerim, Vitet e Kosovës 1998-1999, Gama, Prishtinë; 2001*

- *Gashi Shkelzen, Marrëveshja për Paqe, Copyright, Prishtinë; 2004*

- *Instituti i Historisë Bashkëkohore, Kosova Shtet i Pavarur dhe Sovran, Prishtinë; 2006*

- *Albright Madeleine, Zonja Sekretare, Dudaj, Tiranë; 2003*

- *Puto Arben, Shqipëria Politike 1912-1939, Toena Tiranë; 2009*

- *Weller Marc, Shtetësia e Kontestuar, Koha, Prishtinë; 2009*

- *Akademia e Shkencave, Kosova në Vështrim Enciklopedik, Toena Tiranë; 1999*

- *Gecaj Bajram, Konferenca e Rambujesë, AIKD, Prishtinë; 2009*

- *Myrtaj Nezir, Jehonë Lufte, Radio-Kosova e Lirë, Prishtinë; 2002*

- *Sopjani Enver, Përmbledhje Aktesh Ndërkombëtare për Kosovën, Leoprint, Prishtinë; 2005*

- *Milo Paskal, Kosova nga Rambuje në Pavarësi, Toena Tiranë; 2009*

- *Milo Paskal, Ditari i një Ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001, Toena, Tiranë; 2009*

- *Fischer Joschka, Vitet kuq-gjelbër, Koha, Prishtinë; 2008*

- *Vukaj Shaqir, Rusia dhe Kosova, ''Enriko Koco'', Tiranë; 2007*

- *Histori e Popullit Shqiptar III, Toena, Tiranë; 2003*

- *Clinton Bill, Jeta Ime, Dudaj, Tiranë; 2005*

- *Blair Toni, Për Shqiptarët, ''albPAPER'', Tiranë; 2005*

- *Petritsch Volfgang, Pihleri Robert, Rruga e Gjatë në luftë '' KOHA print'', Prishtinë; 2002*

- *http://www.iszene.com/videos/video/tojuRF-TQJQ*

© Pashtriku.org